



Në pajtim me nenin 36 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, në zbatim të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 10 shkurt 2014, miratoi:

MANUALI PËR LICENCIM BANKAR

PËRMBAJTJA

| | |
|---|-----------|
| 1. HYRJE NË MANUALIN E LICENCIMIT | 4 |
| 1.1. Politika e licencimit..... | 5 |
| 2. PËRMBLEDHJE E PROCESIT TË APLIKIMIT | 7 |
| 2.1. Plani i biznesit, forma e projeksioneve financiare dhe struktura organizative..... | 9 |
| 2.2. Lista e veçante për aksionarët e rëndësishëm..... | 10 |
| 2.3. Kapitali aksionar apo format tjera të kapitalit të bankës | 11 |
| 2.4. Menaxhimi i rrezikut..... | 11 |
| 3. AKTIVITETET FILLESTARE TË LICENCIMIT | 12 |
| 3.1. Licencat e reja bankare..... | 12 |
| 3.2. Vendimi paraprak | 13 |
| 3.3. Organizimi i një banke të re | 14 |
| 3.4. Procedurat para-hapjes | 14 |
| 3.5. Politikat dhe procedurat e zbatueshme | 15 |
| 3.6. Faktorët për marrjen e vendimit | 16 |
| 3.7. Standardet e shqyrtimit..... | 20 |
| 3.8. Procedura shtesë | 21 |
| 4. DORËZIMI I APLIKACIONEVE PËR LICENCË BANKARE..... | 22 |
| 4.1. Kriteret për vlerësimin e aplikuesve..... | 22 |
| 4.2. Dorëzimi i një aplikacioni | 23 |
| 4.3. Procesimi i aplikacionit | 24 |
| 4.4. Letra e mbështetjes..... | 26 |
| 5. HETIMET PËR HISTORIKUN | 27 |
| 5.1. Zbatueshmëria | 27 |
| 5.2. Politikat kyçe | 27 |
| 5.3. Përmbledhja e procesit | 28 |
| 6. PËRMBAJTJA E PLANIT TË BIZNESIT | 34 |
| 6.1. Analizat e tregut | 34 |
| 6.2. Planet dhe objektivat | 35 |

| | | |
|-----------|---|-----------|
| 6.3. | Struktura e asetëve dhe detyrimeve..... | 35 |
| 6.4. | Kapitalizimi / Plani neto i vlerës | 35 |
| 6.5. | Projeksionet financiare | 36 |
| 7. | EKZAMINIMI I PARA-HAPJES – THEMELIMI I BANKËS SË RE | 37 |
| 7.1. | Qëllimi..... | 37 |
| 7.2. | Qasja..... | 37 |
| 7.3. | Procedurat e ekzaminimit të para-hapjes..... | 38 |
| 7.4. | Kompletimi i ekzaminimit të para-hapjes | 39 |
| 8. | MIRATIMET, LEJET DHE NJOFTIMET E NDRYSHME | 40 |
| 8.1. | Emërimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë..... | 40 |
| 8.2. | Ndryshimi në kontroll | 41 |
| 8.3. | Bashkimet, konsolidimet dhe përvetësimet e bankave..... | 42 |
| 8.4. | Përvetësimet e interesit të kapitalit nga bankat në institucionet financiare..... | 43 |
| 8.5. | Përvetësimet e interesit të kapitalit nga bankat në kompanitë jofinanciare | 44 |
| 8.6. | Akti i themelimit dhe statuti..... | 44 |
| 8.7. | Leja e kërkuara nga BQK-ja..... | 45 |
| 8.8. | Njoftimi i kërkuar për BQK-në | 46 |
| 8.9. | Dega e bankës së huaj | 47 |

SHTOJCAT E APLIKIMIT

- 1 – Formulari i aplikacionit për licencë bankare për bankat vendore
- 2 – Udhëzime për kompletimin dhe dorëzimin e aplikacionit për licencë bankare
- 3 – Lista kontrolluese për kompletimin dhe dorëzimin e aplikacionit për licencë bankare
- 4 – Formulari i aplikacionit për licencë bankare për subjektin e varur dhe degët e bankave të huaja dhe grupeve bankare
- 5 – Formulari i aplikacionit për hapjen e degës ose zhvendosjes së degës/zyrës kryesore brenda Kosovës
- 6 – Formulari i aplikacionit për hapjen e një dege/subjekti të varur jashtë Kosovës
- A – CV individuale – Dokument i bashkëngjitur në aplikacion
- B – Raporti i kompanisë për aksionarët (RK) – Dokument i bashkëngjitur në aplikacion
- C – CV për aksionarët individualë – Dokument i bashkëngjitur në aplikacion
- D – Format e projeksioneve financiare – Dokument i bashkëngjitur në aplikacion

1. HYRJE NË MANUALIN E LICENCIMIT

Manuali i licencimit i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) shpjegon politikat dhe procedurat për të themeluar një bankë të re, për të hapur një degë të huaj, ndryshime në strukturë ose zgjerim të korporatës, p.sh. në aspektin gjeografik apo të zgjerimit të produkteve, etj. BQK-ja lidhur me aktivitetet e licencimit vepron në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare Jobankare (më tutje Ligji mbi bankat), që ka hyrë në fuqi më 12 prill 2012, më tutje si (Ligji për bankat). Ligji për bankat i jep BQK-së autoritetin e përgjithshëm për të rregulluar institucionet financiare duke përfshirë themelimin dhe organizimin e operacioneve bankare.

Manuali ka për qëllim të shërbejë si udhëzues kryesor procedural për menaxhmentin dhe personelin e BQK-së, si dhe për të ndihmuar industrinë bankare apo të tjerët që dëshirojnë të marrin licencë.

Manuali jep udhëzime të veçanta për pranimin dhe vlerësimin e aplikacioneve dhe përcakton dokumentet minimale të nevojshme për analizim të aplikacionit. Lista e dokumentacioneve minimale është vetëm një udhëzues procedural dhe nuk përfshin të gjithë faktorët, që mund të vlerësohen gjatë fazës së analizës. Informacione shtesë mund të kërkohen varësisht nga kompleksiteti i situatës.

Ligji për bankat i siguron BQK-së autoritetin të nxjerrë rregullore dhe të ndërmarrë veprime të tjera të nevojshme për të nxitur dhe për të ruajtur një sistem të qëndrueshëm financiar në Republikën e Kosovës. Konkretisht, neni 85.1 i këtij ligji përcakton se BQK-ja ka autorizim për të nxjerrë rregullore, urdhëresa ose direktiva dhe të ndërmarrë veprime tjera siç e konsideron të nevojshme ose të këshillueshme për të përforcuar qëllimin e këtij ligji.

Detyrat kryesore të BQK-së sipas ligjit për banka janë:

- Lëshimi i licencave për themelimin e bankave, institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare si dhe aprovimet për të gjitha ndryshimet e strukturës organizative të bankave dhe lloje të aktiviteteve dhe aprovimet për emërimin e personelit të tyre menaxhues;
- Mbikëqyrjen e operacioneve bankare dhe marrjen e masave të duhura në përputhje me ligjin;
- Revokimin e licencave bankare në përputhje me ligjin;
- Menaxhimin ose mbikëqyrjen e procedurës së rehabilitimit (administrimit zyrtar) ose likuidimit të bankave dhe fillimin e procedurave të falimentimit;
- Lëshimin e akteve nënligjore, udhëzimet apo veprimet e tjera të nevojshme për rregullimin e aktiviteteve të bankave;
- Kryerjen e vlerësimit të kushteve dhe dhënien e miratimit / mosmiratimit për bankat lidhur me lëshimin e aksioneve.

Objekti i përgjithshëm i BQK-së me rastin e licencimit është që të sigurojë një proces transparent gjithëpërfshirës, i cili ndihmon për të siguruar një mjedis të sigurtë, të qëndrueshëm dhe konkurrues bankar.

1.1. Politika e Licencimit

Objektivi: Politika e licencimit është të sigurojë procedura gjithëpërfshirëse të licencimit në mënyrë që të garantohet siguria dhe qëndrueshmëria e industrisë bankare, për të nxitur besimin e publikut në sistemin financiar të Kosovës dhe për të inkurajuar një mjedis të drejtë dhe konkurrues në treg, në mënyrë që të promovohet zhvillimi i sektorit financiar.

Siç u përmend më lartë, autoriteti për nxjerrjen i kësaj politike të licencimit buron nga Ligji për bankat. Sipas këtij Ligji BQK është përgjegjëse për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve financiare në Republikën e Kosovës. Aplikacionet zyrtare dhe informacionet e kërkuara nga aplikantët siç përcaktohet në këtë manual duhet të dorëzohen në BQK me qëllim të miratimit të aktiviteteve vijuese:

- **Licencat për Banka të Reja ose për Degën e Bankës së Huaj** – Neni 7 i Ligjit për bankat dhe Rregullorja mbi licencimin e bankave dhe degëve të bankave të huaja
- **Zyra Përfaqësuese**– Neni 10 i Ligjit për bankat dhe Rregullorja për hapjen e një zyre përfaqësuese brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës
- **Ndryshimi në Kontroll:**
 - o **Pronësia mbi 10% ose më shumë** – Neni 37 i Ligjit për bankat
 - o **Bashkimet ,konsolidimet & përvetësimet** – Neni 39 i Ligjit për bankat dhe Rregullorja mbi bashkimet dhe përvetësimet e bankave
 - o **Rritja e interesit të kapitalit të bankës në subjektet e tjera juridike** – Nenet 40 dhe 41 të Ligjit për bankat
- **Hapja/Mbyllja/Zhvendosja e Degës/Zyrës Bankare** – Neni 11 në Ligjin për bankat dhe Rregullorja mbi hapjen dhe mbylljen brenda dhe jashtë Kosovës të degëve dhe subjekteve të varura

Vlerësimi i aplikacioneve do të bazohet në procedurat e standardizuara siç janë të përshkruara në politikat e përgjithshme mbikëqyrëse të BQK-së. Procesi mund të përfshijë diskutime me bankën apo propozime të zyrtarëve të bankës, ekzaminimet e bankave, dhe/ose analizat e divizionit për mbikëqyrje nga jashtë e të dhënave të raportuara më parë ose si pjesë e procesit të aplikimit. Zyrtarët e BQK-së mund të kërkojnë hetim për historikun dhe/ose konfirmim të informacionit financiar të paraqitur si pjesë e procesit të aplikimit. Shqyrtimi i historikut personal të zyrtarëve/menaxherëve të lartë do të kryhen për të konstatuar nëse ata i përmbushin kriteret lidhur me kualifikimin, përvojën dhe integritetin, siç përcaktohet me nenin 35 në Ligjin për bankat. Pranimi dhe shqyrtimi i aplikacioneve do të kryhet në vazhdimësi për të gjithë individët/subjektet. Në mënyrë të veçantë,

Vendimet për aplikacionet do të jenë të qëndrueshme, të drejta dhe objektive dhe të bazuara në informacionin e marrë nga aplikuesi dhe nga burime të tjera sic përshkruhet në këtë manual.

Vendimet për aplikacionet në rastin e licencave të reja do të bazohen në gjendjen aktuale për kushtet financiare të institucionit, pajtueshmëria e tyre me rregulloret e zbatueshme dhe ligjeve, përshtatshmërinë e politikave qeverisëse dhe procedurat për menaxhimin e operacioneve dhe kontrollin e rrezikut, si dhe cilësinë e menaxhimit.

Vendimet do të përpunohen brenda një afati kohor dhe institucionet ose aplikantët e rinjë për licencë bankare do të informohen menjëherë për gjetjet paraprake. Kërkesa do të konsiderohet e pranuar kur i gjithë dokumenti i nevojshëm të dorëzohet në BQK së bashku me dëftesat e pagesave përcjellëse. BQK-ja do të ketë afate të caktuara kohore me të cilat do të pranojë informacionin e paraqitur si dhe të marrë një vendim, ose të kërkojë informacione shtesë. Aplikacionet dhe të dhënat e pakompletuara nuk do të merren parasysh për vlerësim.

Departamenti i Licencimit dhe Standardizimit pas shqyrtimit të aplikacionit mund të rekomandojë miratimin apo mosmiratimin e licencës, dhe përcjellë rekomandimin-raportin përmbledhës tek Bordi Ekzekutiv përmes miratimit me shkrim të Zëvendësguvernatorit të Mbikëqyrjes Financiare.

Brenda tre muajve nga data e pranimit të kërkesës për licencë, BQK-ja do të japë aprovim paraprak ose refuzojë aplikacionin dhe e njofton aplikuesin për vendimin e saj me shkrim. Nëse kërkesa është refuzuar zyrtarisht, BQK'ja lëshon njoftimin me shkrim për vendimin e marrë duke cekur arsyet e refuzimit të licencës. Pas njoftimit për refuzim që ju është dhënë aplikuesit, aplikacioni do të konsiderohet i anuluar dhe i pa vlefshëm. Nëse kërkuesi kërkon të ri aplikoj për të njëjtën licencë ose aktivitet tjetër bankar, procesi i aplikimit dhe pagesat përcjellëse do të zbatohen si për një aplikim të ri.

Të gjitha aplikacionet dhe komunikimet në lidhje me aktivitetet e licencimit duhet të drejtohen në Departamentin e Licencimit dhe Standardizimit, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Garibaldi 33, 10000 Prishtinë, Kosovë.

2. PËRMBLEDHJE E PROCESIT TË APLIKIMIT

Aplikuesit do të aplikojnë për licencë bankare në formë të shkruar në BQK. Aplikuesit duhet të kompletojnë “**Formularin e aplikimit për licencim bankar të bankave vendore (Formulari i Aplikimit)**” që gjendet në Shtojcën 1 të këtij Manuali dhe në faqen zyrtare të BQK-së (www.bqk-kos.org) nën aplikacionet. Aplikacioni u adresohet si më poshtë:

- Grupeve aplikuese
- Kompanisë aplikuese/bankës potenciale
- Përfaqësuesve të kompanisë aplikuese/bankës potenciale
- Pronësisë së kompanisë aplikuese/bankës potenciale
- Organizimit dhe kontrollit
- Objektivave të biznesit
- Menaxhimit të rreziqeve
- Mjaftueshmërisë së kapitalit
- Vlera potenciale e shtuar në sistemin financiar të Kosovës

Aplikuesit duhet të përdorin formatet dhe modelet e përcaktuara në formularin e aplikimit të BQK-së. Secili seksion i Formularit të Aplikacionit kërkon që të bashkëngjiten dokumente të caktuara. Aplikuesit mund të përfshijnë informata dhe dokumente shtesë nëse konsiderohet e nevojshme. Të gjitha dokumentet duhet të nënshkruhen dhe të kenë datë në mënyrë të duhur.

Nëse kërkohen informata shtesë, aplikuesit do të kenë 15 ditë shtesë për të dorëzuar informatën e kërkuar. Nëse informata nuk dorëzohet në afatin e paraparë, aplikacioni do të konsiderohet i pakënaqshëm dhe një vendim i pafavorshëm për licencë do të ju jepet aplikuesve.

Një aplikacion do të konsiderohet i pranuar kur të dorëzohen të gjitha informatat ashtu siç janë kërkuar dhe kur paguhet tarifa e duhur. BQK-ja do të ketë në dispozicion 90 ditë që nga data e pranimit të aplikacionit të kompletuar për të aprovuar apo refuzuar aplikacionin. BQK-ja do të informojë aplikuesin për vendimin e marrë me shkrim. Njoftimi për refuzimin e kërkesës do t'i përmbajë arsyet për të cilat është refuzuar licenca.

BQK-ja do të punojë me aplikuesit deri në masën e mundshme në mënyrë që të jetë e mundur për të dhënë një aprovim për licencën e kërkuar. Megjithatë, BQK-ja do të do të refuzojë kërkesën e aplikuesit nëse aplikacioni nuk është i kompletuar ose planet që prezantohen nuk konsiderohen të arsyeshme. BQK-ja do të do t'i refuzojë aplikacionet për licenca të reja bankare nëse ndonjëra prej kërkesave në vijim është e vërtetuar:

- Aplikuesit nuk kanë integritet të lartë dhe/ose janë evidentuar shkelje të mëparshme të rregulloreve bankare.
- Bordet mbikëqyrëse dhe zyrtarët/menaxherët e lartë të bankës nuk kanë integritet të lartë ose nuk kanë përvojë të mjaftueshme për të mbikëqyrur operacionet bankare.

- Objektet, pajisjet dhe mjediset nuk janë të mjaftueshme për të mbrojtur aktivet bankare ose të kryejnë një biznes ashtu si përshkruhet në planin operacional.
- Kapitali fillestar nuk është i mjaftueshëm apo rrjedh nga burimet jo të sigurta apo të pa konfirmuara.
- Kapitali nuk është paguar para hapjes së bankës.
- Plani i biznesit dhe pro forma e projeksioneve financiare janë të paarsyeshme dhe nuk konsiderohen të arritshme duke marrë parasysh supozimet e paraqitura dhe përvojën historike në (tregje) praktikë.
- Aplikuesit, anëtarët e bordit mbikëqyrës ose menaxhmenti i lartë kanë konflikte të interesit që mund të ndikojnë në vendimmarrjen e duhur për bankën e propozuar.
- Nëse dhënia e licencës rrezikon qëndrueshmërinë financiare të bankës së propozuar ose sistemit bankar në përgjithësi.
- Nëse dhënia e licencës rrezikon interesat e depozitarëve të bankës së propozuar dhe Fondit të Sigurimit të Depozitave në Kosovë.
- Nëse dhënia e licencës e zvogëlon në mënyrë substanciale konkurrencën .

Procesi i licencimit nga ana e BQK-së do të përfshijë licencë dyfazëshe. Nëse aplikacioni aprovohet, do të jepet një miratim paraprak të licencës , i cili është i vlefshëm për 12 muaj. Licenca e përkohshme jepet në mënyrë që t'i mundësohet aplikuesve të bëjnë organizimin e bankës dhe të regjistrohet ashtu si kërkohet në Agjensionin për regjistrim të bizneseve në Kosovë. Para se të lëshojë licencën zyrtare BQK-ja do të kryejë një ekzaminim të parahapjes në mënyrë që të vlerësojë nëse banka i ka krijuar kushtet për t'i përmbushur obligimet në kuadër të kushteve teknike dhe të sigurisë së objekteve të saj. Në mënyrë të veçantë BQK-ja do të vlerësojë nëse:

- Menaxhmenti i lartë dhe anëtarët e bordit drejtues janë emëruar në mënyrë të rregullte;
- Kapitali është paguar në pajtueshmëri me kërkesat rregullative;
- Personeli është punësuar dhe trajnuar në detyrat e tyre të përcaktuara;
- Një auditor i jashtëm është angazhuar në mënyrë adekuate;
- Pajisjet e nevojshme për operim janë blerë apo marrë me qira;
- Janë zbatuar të gjitha politikat dhe procedurat e kërkuara me shkrim

Licenca e përkohshme do të zëvendësohet më një licencë zyrtare finale pasi të përcaktohet nga BQK-ja se planet e propozuara janë realizuar , me këtë banka bëhet anëtare e Fondit të Sigurimi të Depozitave në Kosovë.

Aplikuesit e bankave duhet të dorëzojnë informatat e mëposhtme për aksionarët e propozuar, drejtorët dhe menaxherët e lartë të bankës. Referojuni shtojcave A, B& C të këtij Manuali të cilat janë të listuara në faqen zyrtare të BQK-së. BQK-ja kërkon këto informacione në mënyrë që të bëjë një vlerësim të standardeve të "i duhur dhe i përshatshëm" (shih seksionin 5 të këtij Manuali) dhe kritereve të pavarësisë për pranimin fillestar të atyre që janë të propozuara në aplikacionin për licencë. Këto kritere

të vlerësimit janë të detajuara në Rregulloren e BQK-së për drejtorët dhe menaxherët e lartë të bankave, si dhe kërkesave të nenit 35 të Ligjit për bankat.

Në përgjithësi, të gjithë menaxherët e lartë që janë kandidatë për zyrtarë ekzekutivë (zyrtarë kryesorë) duhet të kenë autoritetin e duhur vendimmarrës në kuadër të kompetencave të tyre, Si minimum, informatat duhet të sigurohen për kryeshefin ekzekutiv (menaxherin e përgjithshëm), zyrtarin kryesor për financa, zyrtarin kryesor për operacione dhe zyrtarin kryesor të rrezikut.

Informatat që duhet të jepen në Formularin e Aplikacionit për secilin individ përfshijnë:

- Titullin apo pozitën e veçantë të propozuar në bankën e re
- Emri dhe të dhënat e identifikimit
- Individët e ndërlidhur, kompanitë e ndërlidhura dhe partnerët e biznesit (vetëm për ata që aplikojnë si aksionarë aktual apo të mundshëm)
- Edukimi
- Përvoja profesionale, përfshirë informatat aktuale të punësimit dhe informatat e punësimit të mëparshëm që duhet të përfshijnë së paku pesë vite përvojë në shërbimet bankare dhe financiare.
- Referencat profesionale dhe shoqatat
- Aplikacionet e mëhershme (vetëm për aksionarët)
- Pjesëmarrja në situatat problematike financiare
- Veprat penale dhe masat disiplinore
- Deklaratat financiare/vlera neto (vetëm për aksionarët)

Individi duhet të nënshkruajë se informatat e lartpërmendura janë të vërteta dhe të sakta sipas njohurive më të mira të tyre. Nëse ndonjë ndryshim material në aplikacion ndodh para vendimit të aplikacionit për licencë, individi duhet ta informojë BQK-në brenda pesë ditëve që prej ndryshimit të ndodhur. Nëse personeli i nevojshëm nuk është përcaktuar atëherë aplikuesit duhet ta ofrojnë një plan për llojin e kandidatëve d.m.th përvojën, edukimin për ata që do të punësohen në këtë pozitë.

2.1. Plani i biznesit, forma e projeksioneve financiare dhe struktura organizative

Strategjitë e qarta dhe planifikimi i biznesit janë themelore për operacione të qëndrueshme bankare. Aplikuesit e bankës duhet të kenë plane dhe objektiva të qarta të cilat do të ndihmojnë sigurimin e operacioneve të suksesshme bankare. Këto plane duhet të prezantohen në aplikacionin e aplikuesve për shqyrtim dhe diskutim nga BQK –ja, si një faktor në procesin vendimmarrës për dhënien e licencës.

Procesi i planifikimit fillon me zhvillimin e një plani strategjik afatgjatë që përmban deklaratën e filozofisë së përgjithshme të aplikuesit dhe përcakton vizionin e aplikuesit për ardhmërinë e bankës. Plani afatgjatë plotësohet me planet afatshkurtra të biznesit dhe formën e projeksioneve financiare.

Qëllimi i planit afatshkurtër është të përkthejë qëllimet afatgjata në qëllime specifike dhe objektiva të matshme. Plani afatshkurtër duhet të përshkruajë projeksionet e aktiviteteve financiare dhe rritjen e parashikuar si dhe të mbështetet me mjaftueshmërinë e kapitalit të institucionit.

Informatat në vijim për shqyrtimin e një licence bankare duhet t'i prezantohen BQK-së në formatin e përshkruar në Formularin e Aplikacionit si dhe në Shtojcën D –formën e projeksioneve financiare që gjenden në këtë manual si dhe në faqen zyrtare të BQK-së nën linkun- Aplikacionet:

- Plani strategjik/i biznesit dhe forma e projeksioneve financiare
 - Strategjia e përgjithshme për institucionin financiar dhe qëllimin e parashikuar të tregut (d.m.th. pakicë, industri, komerciale, nënloje të tregut) dhe norma e parashikuar e rritjes për vite (minimum 3 vite).
 - Detajet e llojeve të shërbimeve dhe të produkteve si në edhe jashtë bilancit në fillimin e operacioneve si shtesë e objektivave në të ardhmen.
 - Parashikimi i fillestar i bilancit të gjendjes dhe rritja për periudhën trevjeçare.
 - Menaxhimi i parashikuar i strukturës së aseteve dhe detyrimeve.
 - Projeksionet e pasqyrës së të ardhurave (fitimit/humbjes) për 12 muajt e parë, vitin e dytë dhe të tretë
 - Projeksionet për politikën e pagesës së dividendës dhe rritjes së kapitalit
 - Vlerësimi i kostos organizative dhe burimet e financimit

- Struktura organizative
 - Statuti i bankës dhe aktin e themelimit
 - Planifikimi i personelit (numri i punëtorëve/departamentet)
 - Skema organizative me emrat individual, sipas nevojës
 - Lista e komiteteve dhe përgjegjësitë kryesore (të sigurohen emrat e anëtarëve, të mundshëm)
 - Përshkrimi i pozitës së kryeshefit ekzekutiv (menaxherit të përgjithshëm) dhe zyrtarëve të lartë duke përfshirë kufijtë mesatarë të pagave (përfshirja e bonuseve ose pagesave tjera jomonetare p.sh. automobilat, banimi)

2.2. Lista e veçante për aksionarët e rëndësishëm

Për aksionarët që posedojnë më shumë se 5% të aksioneve të bankës, duhet të sigurohen të dhënat financiare (referojuni shtojcës B & C në këtë manual). Të dhënat financiare do të përfshijnë bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e të ardhurave (fitimin/humbjen) gjatë tre viteve të kaluara.

BQK-ja do të vlerësojë aksionarët e propozuar me mbi 10% të aksioneve për të përcaktuar aftësinë aktuale financiare të individëve apo interesave të tyre të ndërlidhur, që do të mund të ndikonte negativisht në bankën e propozuar.

Informatat e dhëna në BQK duhet të nënshkruhen nga aksionarët me dëshminë për saktësinë dhe kompletimin e tyre.

2.3. Kapitali aksionar apo format tjera të kapitalit të bankës

Pagesa adekuate e kapitalit është e detyrueshme për aprovimin e një licence bankare. Kapitali duhet të jetë i mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat rregullative, si dhe të sigurojë një mbrojtje për biznesin bankar gjatë organizimit fillestar dhe fazave fillestare të operimit. BQK-ja ka të drejtë për të kërkuar rritjen e minimumit të kapitalit për bankën e re bazuar në shqyrtimin e deklaratës së bankës së propozuar, planit të biznesit dhe projeksioneve financiare. Si shtesë, investimet e konsiderueshme në mjetet themelore mund të rezultojnë në rritjen e shumës së kapitalit që kërkohet në mënyrë që të merret licenca.

Si pjesë e aplikacionit për licencë finale, aplikuesit duhet t'i sigurojnë BQK-së detajet e plota mbi shumën e kapitalit, formën dhe burimet. BQK-ja do të konfirmojë burimet dhe do të kërkojë që ato të paguhen para lëshimit të licencës zyrtare. Nëse pagesa e kapitalit nuk realizohet, miratimi paraprak i licencës do të revokohet.

Krahas sigurimit të informatave për shumën dhe burimet e kapitalit për BQK-në, aplikuesit duhet të sigurohen se projeksionet financiare përmbajnë në mënyrë të detajuar dhe adekuate burimet e parashikuara të kapitalit për të mbështetur operacionet bankare përderisa institucioni është solvent. Një politikë e shkruar për dividendën duhet gjithashtu t'i dorëzohet BQK-së. Politika e dividendës duhet t'i bazojë pagesat në përqindje së të ardhurave dhe të jetë pjesë e fitimit të qëndrueshëm.

2.4. Menaxhimi i rrezikut

Me qëllim të implementimit të qasjes së mbikëqyrjes së bazuar në rrezik si pjesë e aplikacionit BQK'së duhet t'i prezentohen edhe politikat dhe sistemet që përshkruajnë fushëveprimin e funksionit të menaxhimit të rrezikut të bankës së re. (Referojuni shtojcës 3 - Lista kontrolluese për plotësimin dhe dorëzimin e aplikacionit për licencë bankare të këtij Manuali). BQK-ja i vlerëson informatat në aplikacion për të vlerësuar sistemet gjithëpërfshirëse të menaxhimit të rrezikut në përputhje me qëllimin, madhësinë dhe kompleksitetin e aktiviteteve të bankës/aplikuesit.

3. AKTIVITETET FILLESTARE TË LICENCIMIT

3.1. Licencat e reja bankare

Përmbledhje e procesit

Procesi i themelimit të një banke të re kërkon angazhim të konsiderueshëm personal dhe financiar nga aplikuesit si dhe kryeshefi i propozuar (drejtori menaxhues). Politika e BQK-së e inkurajon dhe mirëpret një përkushtim të tillë. Përkushtimi i dhënë nga aplikuesit dhe kryeshefi i propozuar do të kenë një ndikim të rëndësishëm në vendimin e BQK-së për aprovimin e licencës së re bankare.

Aplikuesit e një banke me shërbime të plota apo të kufizuara komerciale duhet të marrin licencën nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) para se të fillojnë biznesin bankar. Procesi i licencimit përbëhet nga pesë faza: diskutimet para aplikimit, dorëzimi i aplikacionit dhe procesimi, vendimi paraprak, organizimi i bankës si dhe procedurat e para-hapjes.

Diskutimet para aplikimit

Komunikimet para aplikimit mund të zhvillohen në formën e diskutimeve joformale (p.sh. thirrjet telefonike apo tele konferenciale, e-mailat) dhe takimeve më formale. Sapo të përgatiten aplikuesit për të vazhduar më tej, një përfaqësues i tyre duhet të kontaktojë departamentin e licencimit dhe standardizimit dhe të caktojë një takim parashtrues para aplikimit. Takimi parashtrues udhëhiqet nga Guvernatori apo Zëvendësguvernatori për Mbikëqyrje Financiare (ZGMF), si dhe një zyrtar i lartë përgjegjës për aktivitetet e licencimit. Gjatë takimit para aplikimit, ose në diskutimet jozyrtare aplikuesit inkurajohen që të shtrojnë pyetje dhe të japin informata për veten e tyre, bankën e propozuar dhe tregun në të cilën do të punojnë. Ky diskutim u jep mundësinë aplikuesve që të përgatitin aplikacionin në mënyrë efektive si dhe e rrit aftësinë e BQK-së të procesojë kërkesën në mënyrë efikase.

Personeli i BQK-së do të shqyrtojë bashkë me aplikuesin politikën dhe procedurat e licencimit të BQK-së dhe kërkesat për paraqitjen e një aplikacioni për licencë bankare dhe për organizimin e një banke. (Referojuni **shtojcës 1 – Formulari i aplikimit për licencë bankare për bankat vendore** në këtë manual). Aplikuesit duhet ta rishikojnë plotësisht shtojcën 1 e cila gjendet edhe në ueb-faqen zyrtare të BQK-së, para takimit parashtrues në mënyrë që të njohet me procedurat që kanë të bëjnë me licencimin e një banke të re.

BQK-ja do të pranojë aplikacionet vetëm nëse është mbajtur një takim parashtrues. Pritet që të gjithë aplikuesit e bankës së re të propozuar të marrin pjesë në takimin parashtrues. Personeli i licencimit gjithëherë duhet mbajë procesverbalin e takimeve i cili do të mbahet në dosjen e aplikuesit.

Të gjithë grupet e organizimit duhet të kenë identifikuar kryeshefin ekzekutiv të propozuar para se të paraqitet aplikacioni. Rekomandohet që të shpaloset identiteti i kryeshefit ekzekutiv në aplikacion. Përzgjedhja e kryeshefit ekzekutiv diskutohet më hollësisht tek seksioni **organizimi dhe menaxhmenti** në këtë seksion të manualit.

Paraqitja dhe procesimi i aplikacionit

Pas takimit parashtrues grupi paraqet formularin e aplikacionit që gjendet në shtojcën 1 të këtij manuali. Aplikacioni u adresohet çështjeve si historiku i grupit të aplikuesve, pronësia, organizimi dhe kontrolli, plani i biznesit dhe menaxhimi i rrezikut. Aplikacioni kërkon që aplikuesi të përcaktojë një anëtar të grupit të tyre si zëdhënës. Ky person do të shërbejë si kontakt parësor në mes të BQK –së dhe aplikuesve.

Shënim: Politikat dhe procedurat në këtë seksion i mbulojnë kërkesat për licencim bankar. Një bankë e huaj që dëshiron të themelojë një degë apo subjekt të varur duhet të plotësojë **Formularin e aplikacionit për licencë bankare për subjektin e varur dhe degët e bankave të huaja dhe grupeve bankare** që gjendet në shtojcën 4 të këtij manuali si dhe në faqen zyrtare të BQK-së nën Aplikacionet.

BQK-ja i vlerëson informatat në aplikacion për të përcaktuar nëse banka e propozuar do të operojë në një mënyrë të sigurtë dhe të qëndrueshme dhe do të ketë një mundësi të arsyeshme të suksesit. Një hetim në terren mund të bëhet në bazë të informatave të dorëzuara. Aplikuesit duhet të ofrojnë informata të mjaftueshme në aplikacionin e tyre fillestar në mënyrë që të bindin BQK-në se e kanë konceptuar mirë planin e tyre për të themeluar bankën e re dhe se banka e re ka një perspektivë të arsyeshme për sukses. Në përgjithësi, BQK-ja nuk do t'i pyesë aplikuesit që të zgjerojnë informatat që ata i kanë dorëzuar në aplikacion. Nëse informatat e dhëna nuk janë të mjaftueshme për të përcaktuar perspektivën e bankës për sukses, aplikacioni në përgjithësi do të refuzohet. Megjithatë, gjatë gjithë kohës, BQK-ja mund të kërkojë sqarime ose informata shtesë që me arsye nuk janë pritur që aplikuesit do t'i ofrojnë.

Nëse ndodhin ndryshime të rëndësishme në aplikacion gjatë periudhës së shqyrtimit mund të rezultojnë që BQK-ja të vie në përfundim se aplikacioni origjinal është vjetëruar. Në raste të tilla, aplikacioni origjinal do të konsiderohet i tërhequr dhe do të kërkohet aplikacioni i ri dhe tarifa e aplikimit.

3.2. Vendimi paraprak

Pas shqyrtimit të aplikacionit BQK-ja do të vendosë nëse do të japë miratimin paraprak për vazhdimin e organizimit ose të refuzojë kërkesën për licencimin e bankës së re. Vendimi për dhënien e miratimit paraprak ose të refuzimit të aplikacionit do të behët brenda tre muaj nga data e pranimit të aplikacionit të kompletuar. Miratimi preliminar e paraqet lejimin për vazhdimin me organizimin e bankës sipas planit që është përcaktuar në aplikacion. Mirëpo nuk jep siguri se BQK-ja do t'i japë licencën bankës së re. Nëse aplikacioni refuzohet, letër refuzimi duhet të përmbajë arsyen(et) për refuzimin.

Një ndryshim i rëndësishëm në pronësi, të kryeshefit ekzekutiv, aplikuesve, planit operativ apo kapitalizmit të bankës së re, nga ajo që oshtë prezantuar në fillim, do të rezultojë në atë që BQK-ja të rivlerësojë propozimin fillestar duke marrë parasysh këto ndryshime dhe mund të shkakttojë revokimin e miratimit paraprak.

Miratimi paraprak do të revokohet për shkak të dështimit të ndërmarrjes së të gjithë hapave që kërkohen për të organizuar një bankë ose nëse para hapjes vihet ndonjë informatë në dispozicion të BQK-së, që ofron arsye të mjaftueshme për të ndryshuar vlerësimin e saj për perspektivën e suksesit të bankës së re të propozuar.

3.3. Organizimi i një banke të re

Aplikuesit do t'i kenë dymbëstjetë (12) muaj nga data e miratimit paraprak për të kompletuar organizimin e bankës së re. Dështimi që të kompletohet organizimi brenda 12 muajve do të shkaktojë revokimin e miratimit paraprak. Gjatë fazës së organizimit, banka punëson pjesën tjetër të menaxhmentit të saj, themelon mjediset e saj bankare në vendet e propozuara, paguan kapitalin dhe zhvillon sistemet e saj bankare..

Në përgjithësi, BQK-ja nuk do të konsideroj si të favorshme një propozim apo një sërë propozimesh që do t'i ndryshonin materialisht faktorët themelor në të cilat vendimi për miratimin e aplikacionit ishte bazuar fillimisht. Nëse gjatë fazës së organizimit shfaqen ndryshime që në mënyrë të rëndësishme i ndryshojnë faktet në të cilat BQK-ja e ka bazuar miratimin e saj paraprak ai miratim mund të revokohet. Megjithatë, disa ndryshime e përmirësojnë aplikacionin dhe aplikuesit nuk duhet të hezitojnë të propozojnë një ndryshim që mund të jetë i dobishëm. Të gjitha ndryshimet e propozuara shqyrtohen për nga rëndësia dhe efektet e tyre mbi bazën e përdorur për të dhënë miratimin paraprak. Nëse duhet të bëhet një shqyrtim i konsiderueshëm shtesë, mund të kërkohet edhe një tarifë shtesë.

Për shembull, revokimi i miratimit paraprak mund të rezultojë nga ndryshimet në:

- Përbërjen e grupit organizues.
- Kryeshefin ekzekutiv.
- Shpërndarjen e pronësisë.
- Informata negative mbi kryeshefin ekzekutiv ose aplikuesit që nuk janë shpalosur më parë.
- Gjendjen financiare të aplikuesve.
- Gjendjen e kompanisë amë si kompani garantuese.
- Gjendjen e filialeve ose bankave pjesëmarrëse.
- Përmbajtjes së planit operativ.

Aplikuesit duhet të njoftojnë BQK-në menjëherë (brenda pesë ditëve) për ndryshimet materiale, në rastet kur ato ndodhin apo janë të propozuara. Në përgjithësi miratimet e dhëna paraprakisht do të revokohen nëse BQK-ja zbulon shkelje materiale të ligjit, keqinterpretime ose ndonjë aktivitet mashtrues nga ana e aplikuesve.

3.4. Procedurat e para-hapjes

Së paku dy javë para se banka të planifikojë hapjen, BQK –ja e bën ekzaminimin e saj që të sigurohet se i ka plotësuar të gjitha kushtet për fillimin e biznesit bankar. Nëse ekzaminimi vërteton se banka i ka përmbushur kërkesat për hapjen e saj atëherë jepet licenca. Nëse ekzaminimi zbulon përjashtime të shumta ose shmangie të konsiderueshme nga propozimi i miratuar fillimisht, ose BQK-ja zbulon arsye tjera për rivlerësimin e aftësive të aplikuesve (siç është gjendja e përkeqësuar financiare e aplikuesve) hapja mund të shtyhet ose licenca mund të mos jepet dhe miratimi paraprak mund të revokohet.

3.5. Politikat dhe procedurat e zbatueshme

Tarifat e aplikimit

Tarifat e përshtatshme të aplikimit sipas nenit 86 të Ligjit mbi bankat duhet ta shoqërojnë kërkesën për licencën e një banke. Të gjitha tarifat e kërkuara të aplikimit janë të paraqitura në Skemën e Tarifave që gjendet në ueb-faqen zyrtare të BQK-së. Një aplikacion konsiderohet si i paplotë nëse tarifa e depozitimit nuk është bërë. Tarifat e aplikimit janë të pakthyeshme.

Opinionet Ligjore

BQK-ja pret nga aplikuesit që çështjet ligjore t'i hulumtojnë me kujdes para se të paraqesin aplikacionin, në mënyrë që të sigurojnë mbështetje ligjore të aplikimit. Si aplikuesit ashtu edhe BQK-ja përfitojnë kur aplikuesit i adresohen në mënyrë adekuate çështjeve të rëndësishme ligjore të ngritura gjatë aplikimit. Kështu që, procesimi i aplikacionit mund të vazhdojë në mënyrë më efektive.

Organizimi dhe Menaxhmenti

Menaxhmenti i lartë ka rëndësi kritike për suksesin e një banke të re. Përzgjedhja e një kryeshefi dhe menaxhmenti të lartë të kualifikuar dhe profesional, si dhe një bordi të drejtorëve adekuat është një ndër detyrat më me rëndësi të grupit të organizuar. Kryeshefi ekzekutiv i propozuar duhet të përfshihet në mënyrë aktive në zhvillimin e aplikacionit për licencë dhe duhet të jetë plotësisht i njoftuar me planin e biznesit të bankës së propozuar pasi që ai person duhet të zbatojë me sukses drejtëpërdrejtë planin e propozuar të bankës. Gjithashtu edhe aplikuesit janë përgjegjës për një hetim të plotë të historikut dhe kualifikimeve të kandidatit para dorëzimit të aplikimit në BQK. Përzgjedhja e një kryeshefi ekzekutiv të cilin BQK-ja e konsideron se përvoja e më hershme bankare e të cilit është konsideruar si jo e kënaqshme, atëherë propozimi është i papranueshëm për BQK-në. Kjo mund të reflektojë negativisht në aplikuesit dhe të rezultojë në mosmiratimin e miratimit paraprak.

Aplikuesit poashtu duhet të sigurojnë një përshkrim të detajuar të historikut të të gjithë kandidatëve të propozuar për menaxhment të lartë dhe bord të drejtorëve, duke përfshirë përvojën dhe kualifikimet në përputhje me informatat e kërkuara në aplikacion. Personat e propozuar duhet që të kompletojnë dhe të dorëzojnë Shtojcën A-CV-në individuale—Shtojcën e Formularit të aplikacionit që gjendet në këtë manual si dhe në faqen zyrtare të BQK-së. Të gjitha informatat identifikuese që përfshijnë emrin e personit, adresën, numrin personal të identifikimit, emrat e institucioneve financiare ku personi është apo ishte i punësuar, organizatat tjera ku personi është apo ishte përfshirë si një zyrtar, do të trajtohen në mënyrë konfidenciale.

Kërkesat kryesore për kryeshef ekzekutiv janë prezentuar si në vijim.

- Duhet të posedojë aftësitë e nevojshme profesionale dhe t'i përshtatet nevojave të bankës së re.
- Duhet të jetë tërësisht i njoftuar me planin operativ të bankës së re të propozuar.

- Duhet të ketë menaxhuar me sukses një bankë apo institucion financiar të ngjashëm ose të ketë një përvojë të suksesshme si një zyrtar në një fushë përkatëse të lidhur me strategjinë e bankës së propozuar.
- Duhet të ketë përvojë të mjaftueshme ekzekutive.

Këto udhëzime janë në përputhje me kërkesat ligjore të BQK-së që një person adekuat të zgjidhet për udhëheqjen e bankës së re. Bazuar në kërkesat e **rregullores për drejtorët dhe menaxheret e lartë të bankave** vendimet sa i përket kryeshefit ekzekutiv të propozuar bazohen në përshtatshmërinë e personit për pozitën e caktuar në bankën e re, dhe nuk kanë për qëllim që të përcaktojnë kualifikimin për punë në institucionet bankare ekzistuese.

Banka e propozuar duhet të jetë në gjendje të tërheqë zyrtarë ekzekutivë me përvojë, kompetenca dhe gatishmëri për të menaxhuar bankën siç kërkohet nga plani operativ. Nëse plani operativ përmban propozime për lloje të shërbimeve të specializuara, zyrtarët ekzekutivë duhet të kenë një përvojë përkatëse në zhvillimin dhe administrimin e këtyre shërbimeve. Identifikimi i zyrtarëve në një kohë më të hershme është i dobishëm dhe reflektohet pozitivisht në grupin organizativ dhe planin e tij operativ.

Aplikuesi duhet të kenë një plan për shërbimet që do të jipen në komunitetin e tij. Planin operativ duhet të reflektojë planet e grupit organizativ për arritjen e obligimeve të pranuar të bankës për përmbushjen e nevojave së klientëve në tërë komunitetin.

3.6. Faktorët për marrjen e vendimit

Faktorët pozitivë që BQK-ja gjithashtu duhet t'i marrë parasysh gjatë vendosjes nëse duhet të miratojë apo refuzojë kërkesat për organizimin e një banke janë:

- Perspektivat e fitimeve të ardhshme të bankës.
- Karakterin e përgjithshëm të menaxhmentit.
- Mjaftueshmërinë e strukturës së saj të kapitalit. (Shënim: Në rastin e kërkesës për licencë për një degë të një banke të huaj, paragrafi 2 i nenit 4 i Rregullores për licencimin e bankave dhe degëve të bankave të huaja ka përcaktuar se Banka e huaj që aplikon për të kryer veprimtari bankare përmes degës së saj, duhet të mbajë në BQK një depozitë në barasvlerën e kapitalit, jo më pak se 7 milionë Euro siç është përcaktuar me nenin 17 të Ligjit për bankat).
- Komoditetet dhe nevojat e komunitetit/publikut për shërbime bankare.

Gjatë zbatimit të këtyre, BQK-ja do të merr parasysh parimet e mëposhtme:

- BQK-ja ka përgjegjësi për ruajtjen e një sistemi bankar të qëndrueshëm.
- Tregu është normalisht rregullatori më i mirë i aktiviteteve ekonomike.
- Konkurrenca promovon një sistem bankar të qëndrueshëm dhe më efikas që i shërben më mirë klientëve.

Plani operativ

Plani operativ i grupit organizativ duhet të paraqesë se banka e propozuar do të:

- Ketë perspektivë të arsyeshme të fitimit.
- Do të jetë në gjendje të punësojë dhe mbajë menaxherët kompetentë.
- Mirëmbajë kapitalin adekuat.
- Do të operojë në mënyrë të sigurtë dhe të qëndrueshme në përputhje me rregulloret e aplikueshme, politikat dhe procedurat.

Supozimet e planit operativ për tregun duhet të jenë të arsyeshme dhe në përputhje me parashikimet. Plani operativ duhet të prezantojë të dhëna që saktësisht e reflektojnë gjendjen ekonomike të tregut të përcaktuar dhe i adresohen ndryshimeve statusore dhe rregullatore që mund të ndikojnë në operacionet e bankës së propozuar. Propozimet duhet t'i reflektojnë "realitetet" e tregut. Aplikuesit, ashtu si edhe kryeshefi ekzekutiv i propozuar duhet të jenë të njoftuar me planin operativ dhe rolin e tyre në implementimin e suksesshëm të tij.

Kapitali

Aplikuesi poashtu duhet të planifikojë ngritjen e kapitalit të mjaftueshëm në mënyrë që të mbështesin madhësinë e parashikuar dhe llojin e biznesit të planifikuar të bankës. Minimumi i kapitalit është i përcaktuar në nenin 15 të Ligjit për bankat dhe Rregulloren e BQK-së për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave, ose me urdhër të BQK-së. Faktorët që merren në konsideratë në përcaktimin e adekuatshmërisë së kapitalit përfshijnë:

- Shpenzimet e organizimit.
- Perspektivat e fitimit.
- Kushtet ekonomike dhe të konkurrencës në tregun që do të shërbehet.
- Përvoja dhe kompetenca e menaxhmentit.
- Rreziqet e mundshme në menaxhimin e aseteve dhe detyrimeve.
- Shuma e investimeve në mjete themelore.
- Besueshmëria e planeve për të shtuar kapital, ose aftësia e aplikuesve për të siguruar kapital shtesë kur nevojitet.

Kapitali i prekshëm i klasës së parë, pasi që shpenzimet e organizimit të kapitalizohen ose t'i ngarkohen kapitalit të bankës, duhet të jetë adekuat për të zbatuar me sukses planin operativ të propozuar të bankës. Aplikuesit duhet t'i arsyetojnë BQK-së nivelin e propozuar të kapitalit. BQK-ja mund të përcaktojë se shumat më të larta apo të ulëta të kapitalit janë të nevojshme bazuar në kushtet e tregut vendor ose planit operativ të grupit organizativ.

Në përgjithësi, BQK-ja nuk i kosideron të favorshme propozimet e bankës së re që mbështeten në borxhe apo instrumente tjera që kërkojnë kthimin apo dividendët gjatë viteve të para të operimit të bankës së re.

Kapitali duhet të paguhet me kohë dhe banka duhet të përmbushë kushtet tjera në mënyrë që të marrë licencën për fillimin e operacioneve siç paraqitet në nenin 8.5 të Ligjit për bankat. Këto kushte duhet të përmbushen brenda një viti pas datës së miratimit paraprak të licencës, përndryshe miratimi paraprak i licencës do të jetë revokohet.

Kompensimi i aplikuesve

BQK-ja e merr parasysh karakterin e përgjithshëm të menaxhmentit dhe adekuatshmërinë e strukturës së kapitalit kur bën vlerësimin e licencimit të një banke të re. Propozimet për kompensim që reflektojnë negativisht në këto aspekte të një aplikacioni janë të papranueshme.

Udhëzimet e BQK-së për propozimet e kompensimit iu përmbahen këtyre parimeve të përgjithshme:

1. Kompensimi duhet të strukturohet në atë mënyrë që mos të pengojë aftësinë e ardhshme të bankës për të mbledhur kapitalin e kërkuar.
2. Kompensimi duhet të strukturohet në atë mënyrë që aplikuesit të supozojnë rrezikun financiar. Shpërblimet duhet të jenë në proporcion me suksesin financiar të bankës.
3. Kompensimi duhet të strukturohet që çdo fitim të jetë proporcional me rrezikun financiar të çdo aplikuesi dhe suksesin e bankës.

Propozimet që i mundësojnë aplikuesve të blejnë aksione të bankës me çmim fillestar më të ulët se që paguhet nga investitorët tjerë janë gjithashtu të papranueshme. Marrëveshje të tilla mund të pengojnë aftësinë e bankës për të mbledhur kapitalin e nevojshëm pasi që investitorët tjerë nuk e marrin kontrollin në proporcion me investimet e tyre financiare. Përveç kësaj ato mundësojnë kontrollin nga aplikuesit pa një angazhim financiar proporcional. Vlerësimi i menjëhershëm i aksioneve i lejon aplikuesit të përfitojnë thjesht nga themelimi i bankës pa marr parasysh suksesin e saj financiar.

Një tjetër metodë e kompensimit të aplikuesve të bankës së re është me garanci. Planet tipike u japin aplikuesve një garanci për secilën pjesë të aksioneve të blera. Kur banka është e suksesshme, aplikuesit mund të përfitojnë nga shtimi i investimeve të tyre në bankë me një çmim më të ulët se çmimi aktual i tregut. Madhësia e shpërblimit varet nga sukcesi financiar i bankës të reflektuar në rritjen e çmimeve të aksioneve të saj në krahasim me çmimin fillestar të emetuar.

Hetimet për të kaluarën

Grupi i organizimit dhe kryeshefi i saj ekzekutiv duhet të kenë përvojën, kompetencën dhe gatishmërinë për të drejtuar punët e bankës në një mënyrë të qëndrueshme, të sigurtë dhe ligjore. Grupet organizuese që nuk i përmbushin këto kritere u refuzohet kërkesa për organizimin e bankës. Aplikuesit dhe drejtorët ekzekutivë përvoja e mëhershme bankare e të cilëve është e lidhur me një institucion financiar të dështuar apo problematik do të shqyrtohet detalisht nga BQK-ja për të përcaktuar aftësinë e tyre që në mënyrë të sigurt dhe adekuate të kryejnë detyrat e tyre.

BQK-ja do të kryejë verifikimin e të kaluarës për kandidatët në lidhje me pozitën e kryeshefit ekzekutiv,

zyrtari kryesor për financa, zyrtari kryesor për operacione dhe zyrtari kryesor për risk ose të secilit person që përcaktohet nga BQK-ja, si edhe aplikuesve, aksionarëve kryesorë dhe anëtarëve të bordit drejtues. Hetimi i BQK-së do të shqyrtojë kompetencën, përvojën, integritetin, dhe aftësitë financiare të këtyre personave. BQK-ja do të bëjë një përcaktim të pavarur të saktësisë dhe kompletimit të çdo informacioni të marrë në lidhje me këta persona dhe BQK-ja nuk duhet të ketë asnjë vërejtje për shërbimin e tyre në kapacitetet e propozuara.

Të gjitha informatat e dorëzuara në lidhje me çdo kërkesë subjekt për shqyrtim dhe verifikim. Çdo prezantim i gabuar material ose lëshim i ndonjë fakti në një aplikacion, përgjithësisht, do të rezultojë në refuzimin e tij. Nëse ky prezantim i gabuar ose lëshim zbulohet pasi që të hapet banka, licenca mund të revokohet dhe banka të mbyllet.

BQK-ja kryen verifikime rutinore të së kaluarës për personat që kërkojnë të hyjnë në sistemin bankar. BQK-ja kryen verifikime standarde të së kaluarës për të gjithë personat e tillë përmes:

- Ministrisë së Punëve të Brendshme
- Regjistrin të Kredive të Kosovës
- Të dhënat e agjencive rregullatore në vendet tjera ku palët kanë qenë të lidhura me institucionet nën një juridiksion të një agjencie jashtë vendit.

BQK-ja nuk do të mund të kryejë disa prej verifikimeve standarde të së kaluarës në qoftë se në rastet individuale kryerja e verifikimit do të jetë e tepërt, dhe nuk do t'i shërbejë qëllimit të BQK-së për hetim të së kaluarës ose për arsye tjera. Megjithatë BQK-ja do të ndjekë çdo verifikim shtesë të së kaluarës që duket i arsyeshëm për rrethanat. BQK-ja mund të kërkojë informata shtesë që paraqiten si të nevojshme për të bërë një përcaktim të pavarur të saktësisë dhe kompletimit të ndonjë deklaratë në aplikacionin për licencim.

Faktorët e tjerë

Çdo kontratë me zyrtarët bankarë për shërbime duhet të përfshijë dispozitat e obligimeve të adresuara dhe opsioneve në dispozicion për palët në rast se BQK-ja nuk aprovon aplikacionin për licencim ose ka vërejtje në përzgjedhjen e zyrtarit të propozuar. Përveç kësaj, BQK-ja shqyrton dhe nuk duhet të ketë asnjë vërejtje për anëtarët e bordit të drejtorëve (BQK-ja aprovon anëtarët fillestarë të Bordit dhe çdo ndryshim të anëtarëve të Bordit pasi që të hapet banka).

BQK-ja kërkon që para hapjes, banka të angazhojë një auditor të pavarur të jashtëm për kryerjen e një auditimi në përputhje me standardet e përgjithshme të pranuar ndërkombëtarisht të një fushëveprimi të mjaftueshëm për t'i mundësuar auditorit të marrë një opinion mbi pasqyrën financiare të bankës. Periudha e auditimit do të fillojë në datën kur aplikuesi e krijonë një trup korporativ dhe mund të përfundojë në çdo fund të tremujorit kalendarik, jo më vonë se 12 muaj pasi që të hapet banka. BQK-ja pret që auditimet e tilla të kryhen çdo vit. Angazhimi i një auditori do të verifikohet gjatë ekzaminimit para hapjes.

Grupet e organizimit që dëshirojnë të aplikojnë për miratimin e themelimit të degëve në lidhje me

aplikacionin e tyre për bankën e re duhet të:

- Duhet të paraqesin një aplikacion të kompletuar në BQK siç kërkohet në **Rregulloren për hapjen dhe mbylljen brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës të degëve dhe subjekteve të varura të bankave**, si dhe paraqitjen e duhur të tarifës për dorëzim të dokumentacionit. Referohuni **Formularit të aplikacionit për hapjen e degës apo zhvendosjen e degës/zyrës qendrore brenda Kosovës** që gjendet në Shtojcën 5 të këtij manuali si dhe në faqen zyrtare të BQK-së. .
- Të reflektojnë ndikimin e degëve në planin operacional.

3.7. Standardet e shqyrtimit

BQK-ja do t'i kushtojë rëndësi të veçantë strategjive të biznesit dhe të menaxhmentit të parapara në planin operativ pasi që ato lidhen me tregun dhe me kualifikimet e kryeshefit ekzekutiv të propozuar. Plani duhet të jetë i arsyeshëm dhe të bindë shqyrtuesin se rezultatet e parashikuara janë në përputhje me mjedisin konkurrues.

Për aplikacionet e sponsorizuara nga individë të lidhur me organizata tjera bankare apo financiare, BQK-ja do të vlerësojë të dhënat e performancës së institucionit(eve) përkatëse. BQK-ja mund të shqyrtojë raportet vjetore të aksionarëve raportet e ekzaminimeve, pasqyrat financiare dhe çdo informatë që ka në dispozicion në cilësinë e mbikëqyrësit. Shkalla në të cilën gjendja e bankës do të ndikohet nga gjendja e përgjithshme e filialeve të lidhura me të, do të merret në konsideratë. Problemet serioze të një organizate të lidhur mund të kërkojnë vëmendjen e plotë të menaxhmentit për të siguruar zgjidhjen e këtyre problemeve para një zgjerimi të mëtejshëm.

BQK-ja pranon se forca e bankës amë, e kombinuar me mbështetjen direkte që ofron, mund të zvogëlojë shqetësimet në lidhje me kapitalin, planin operativ ose shqetësimet e tjera mbikëqyrëse. Në të kundërtën, gjendja e vështirë e bankës amë dhe/ose subjektit të varur të saj ose mungesa e çdo evidence për përkrahjen e kompanisë amë për subjektet e varura të saj mund të rezultojë në veprime negative në lidhje me bankën e propozuar, edhe pse propozimi mund të jetë i dobishëm.

Si rrjedhojë, BQK-ja mund të refuzojë aplikacionin për bankë të re të financuar nga një kompani e madhe nëse gjendja e kompanisë ose e subjekteve të varura është shqetësim i mbikëqyrësit amë. Në të kundërtën, kur kompania amë ose institucionet e lidhura me të shërbejnë si burime substanciale të forta, aplikacionet mund të miratohen edhe në tregjet në të cilat kushtet ekonomike janë të dobëta dhe /ose kur kushtet konkurruese janë të një intensiteti të lartë.

Aplikuesit mund të ndryshojnë kërkesën gjatë procesit të shqyrtimit nëse ata e konsiderojnë të nevojshme. Ndryshime të qenësishme mund të rezultojnë në caktimin e taksave shtesë dhe /ose arkivimi origjinal i kërkesës të konsiderohet i tërhequr. Ndryshime të shumta në një kërkesë gjatë procesit të shqyrtimit mund të mos reflektojnë pozitivisht në grup.

3.8. Procedura shtesë

Pasi një aplikacion është paraqitur, ai shqyrtohet për t'u siguruar se teknikisht është i kompletuar. Nëse një aplikacion nuk është i kompletuar, do të kthehet prapa për përmirësime, ose aplikuesit do të informohen për përmirësimet e kërkuara me letër nëse ato përmirësime janë teknike. Aplikuesve në përgjithësi do t'ju lejohet një mundësi për t'i kryer përmirësimet teknike. Nëse përmirësimet nuk janë bërë me rastin e ridorëzimit aplikacioni mund të konsiderohet si i tërhequr dhe tarifa e arkivimit nuk do të kthehet. Një aplikacion është teknikisht i kompletuar atëherë kur të gjitha pyetjet janë përgjigjur dhe informatat e kërkuara nga BQK'ja janë dorëzuar. Kompletimi teknik nuk nënkupton se përmbajtja do të jetë e pranueshme ose se aplikacioni do të miratohet. Në këtë kontekst "mangësitë teknike" nënkuptojnë informatat që nuk janë dhënë me rastin e dorëzimit fillestar. Të aplikacionit.

Të gjitha kontaktet në mes të BQK-së dhe grupit organizativ do të bëhen përmes zëdhënësit që është identifikuar në takimin para dorëzimit të aplikacionit dhe në aplikacion. Zëdhënësi duhet të jetë anëtar i grupit organizativ të bankës së propozuar. Nëse është e nevojshme BQK-ja mund të zhvillojë një takim me zëdhënësin, kryeshefin ekzekutiv, dhe ndonjërin nga anëtarët e grupit organizativ për të diskutuar në lidhje me aplikacionin. Atëherë kur banka është në procesin e organizimit (pas miratimit paraprak) drejtorët organizativë po ashtu duhet të caktojnë njërin nga anëtarët e tyre si korrespondent për kontaktet me BQK-në.

Të gjithë anëtarët e bordit drejtues duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara më herët në **Rregulloren për drejtorët dhe menaxheret e lartë të bankave**. (Referohuni seksionit 5 të këtij Manuali – Hetimet për historikun parimet e duhura dhe të përshtatshme).

Në përgjithësi, shpenzimet e kryera nga aplikuesi për paraqitjen e aplikacionit dhe organizimit të një banke mund t'i ngarkohen kapitalit bankar ose mund të kapitalizohen nëse dokumentohen dhe shpalosen para aksionarëve aktualë. Në takimin e parë të aksionarëve, këto shpenzime dhe angazhime mund të miratohen dhe mund të përfshihen si listë e specifikuar në procesverbalin e takimit. Shpenzimet zakonisht përfshijnë tarifën e aplikimit dhe ato organizative, koston e shërbimeve profesionale dhe konsultuese, shpenzimet e udhëtimit, shtypjes, postare, telefonit, furnizimit, rrogat, qirasë dhe marrjen me qira apo blerjen e mjeteve themelore. BQK-ja mund të ndalojë pagesën e shpenzimeve të tepërta nga fondet e bankës ose mund të kërkojë kapital shtesë, të mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve të tepërta të ngritura para hapjes së bankës.

Edhe pse një ndihmë profesionale dhe konsultative është e zakonshme dhe mund të ngarkohet në mënyrë adekuate për shpenzimet operative të bankës nga aplikuesit pritet ,që të kontribuojnë me kohë për organizimin e bankës dhe nuk duhet të ngarkojnë një pagesë të tepërt në llogaritë e saj për këto shërbime. Në përgjithësi, ekzistenca e kontratës që përfshinë një tarifë shtesë për çdo veprim, vendim apo shmangie nga ana e BQK-së do të jetë bazë për mosmiratimin e aplikacionit apo tërheqjen e miratimit paraprak. Shpenzimet organizative për aplikacionet e paaprovuara janë përgjegjësi e vetme e grupit organizues.

Vendimi për të marrë me qira apo për të blerë e lokalet e bankës është përgjegjësi e grupit organizues. Megjithatë, ka edhe kufizime rregullative për investimet në mjete themelore. (Shih **Rregulloren për kufizimet në mbajtjen e pasurisë të paluajtshme dhe të luajtshme**) Procedimet nga shitja e aksioneve duhet të mbahen në ruajtje dhe nuk mund të përdoren për financimin e ndërtimit/blerjen e lokaleve të bankës.

4. DORËZIMI I APLIKACIONEVE PËR LICENCË BANKARE

Secili aplikues duhet të vlerësojë nëse modeli i tij i biznesit të propozuar të institucionit financiar:

- kërkon një licencë bankare (duke përfshirë edhe përmbushjen e definicionit “bankë” në Ligjin për bankat);
- përputhet me kërkesat e BQK-së ; dhe
- do të përputhet me kërkesat që duhet të respektohen nga banka / institucionet financiare mbi një bazë të vazhdueshme.

Pas këtij vlerësimi aplikuesi duhet të caktojë një takim paraprak konsultativ me Departamentin e Licencimit dhe Standardizimit të BQK-së në numrin e telefonit +381 (0) 38 / 222-055 lokali 303.

BQK-ja mirëpret aplikimet për licencë bankare, ku banka e propozuar/institucioni financiar (aplikuesi) duhet të plotësojë kriteret e BQK-së, siç është përcaktuar në Departamentin e Licencimit dhe Standardizimit për **Formën e aplikimit për licencë bankare për bankat vendore** që gjinden në Shtojcën 1 të këtij manuali, legjislacioni ka të bëjë me biznesin bankar dhe të gjitha kërkesat tjera.

Aplikuesi duhet të jetë i njohur me të gjitha dispozitat ligjore të zbatueshme për të gjitha bankat / institucionet financiare në Kosovë. Aplikuesit duhet të kuptojnë qëllimin dhe zbatimin e dokumenteve të konsultimit dhe të gjitha kërkesat e reja të lëshuara nga BQK-ja, detajet e të cilit janë publikuar nën Rregulloret Bankare në faqen e internetit të BQK-së: www.bqk-kos.org.

4.1. Kriteret për vlerësimin e aplikuesve

Në bazë të nenit 7 të Ligjit për bankat një aplikim për një licencë duhet të jetë në formë të tillë siç përshkruhet nga BQK-ja dhe duhet të përmbajë veçoritë të cilat kohë pas kohe mund të përcaktohen nga BQK.

Fushat kryesore që konsiderohen nga BQK-ja në vlerësimin e aplikimeve për licencë bankare përfshijnë:

- Strukturën e pronësisë;
- Objektivat e aplikuesit dhe aktivitetet e propozuara;
- Strukturën ligjore (statuti dhe aktet e themelimit);
- Planin e biznesit (duke përfshirë strukturën organizative, marrëveshjet e qeverisjes së korporatave, personelin kryesor, departamentet etj - Referojuni Seksionit 6 - Përmbajtjes së planit të biznesit në këtë manual);
- Mbikëqyrjen e rrezikut (p.sh. auditimi, pajtueshmëria, menaxhimi i rrezikut, kredia, likuiditeti, tregu , operacionet, kontrolli financiar, kontrollet e brendshme, etj);
- Projektionet e kapitalit;

- Projektionet financiare;
- Informacione rreth bankës amë/grupit të aplikuesit;
- Mbikëqyrja e konsoliduar e bankës amë/grupit; dhe
- Të tjera sipas nevojës.

Kërkesat e BQK-së në lidhje me secilin prej këtyre titujve, janë të detajuara në ueb -zyrtare të BQK-së (www.bqk-kos.org) te aplikacionet në shtojcën 3 "**Lista kontrolluese për plotësimin dhe dorëzimin e aplikacioneve për licencë bankare**". Kjo Listë kontrolluese është gjithashtu edhe në shtojcën 3 të këtij manuali.

BQK-ja miraton licencën për bankat/institucionet financiare në bazë të informacionit të dhënë si pjesë e procesit të aplikimit, me fokus të veçantë në qeverisjen e korporative dhe marrëveshjet mbikëqyrëse, menaxhimin e rrezikut, kontrollin e brendshëm, planit të biznesit dhe kapitalit, si dhe parashikimet financiare. Në këtë aspekt nga të gjithë aplikantët do të kërkohet për të vepruar në përputhje me informatat e dorëzuara në mbështetje të aplikacionit për licencë bankare.

4.2. Dorëzimi i një aplikacioni

Para dorëzimit të një aplikacioni, BQK-ja kërkon që të gjithë aplikuesit të takohen me Guvernatorin ose me Zëvendësguvernatorin për Mbikëqyrjen e Financave dhe Drejtorin e Departamentit të Licencimit dhe Standardizimit. Në këtë takim të para-aplikimit, një anëtar i grupit organizativ duhet të identifikohet si zëdhënës për të përfaqësuar aplikuesit për të gjitha kontaktet e mëvonshme me BQK-në.

Pas takimit të para-aplikimit, të gjitha kërkesat e informatave të paraqitura në listën kontrolluese duhet të sigurohen për BQK-në në mënyrë që të përbëjnë një aplikacion të kompletuar për licencë bankare. Lista kontrolluese duhet të dorëzohet së bashku me të gjitha dokumentet përkatëse, mbështetëse dhe së bashku me kërkesën për licencë. Për lehtësim të referimit, çdo pjesë e aplikimit duhet të jetë me numër dhe të ndjekë formatin e listës kontrolluese. Lista kontrolluese nuk do të thotë t'i referohemi tërësisht të gjitha informatave përkatëse lidhur me një kërkesë për një licencë bankare dhe aplikanti duhet të zgjerohet në informacionin e kërkuar kur është e nevojshme, sipas natyrës specifike të biznesit të propozuar.

Aplikanti nëse është bankë e huaj para dorëzimit të aplikacionit në BQK gjithësesi duhet t'i bëjë një kërkesë mbikëqyrësit të konsoliduar të aplikuesit, për të marrë pëlqimin e themelimit të bankës në Kosovë.

BQK-ja nuk do të fillojë procesin e saj të shqyrtimit deri sa të pranohet aplikacioni i kompletuar për licencë. Të gjithë hapat e arsyeshëm duhet të merren nga aplikuesi për t'u siguruar që informacioni i dhënë në BQK në mbështetje të propozimit të licencës dhe aplikimit të mëvonshëm është i saktë dhe i plotë. Nëse aplikacioni fillestar për licencë dorëzohet në BQK për shqyrtim dhe është i pa kompletuar qoftë edhe detal i vogël (p.sh. detajet e harruara për drejtorët) atëherë aplikacioni do të kthehet.

4.3. Procesimi i aplikacionit

BQK-ja së pari do të shqyrtojë aplikacionin për licencë dhe dokumentacionin mbështetës. Në vazhdim të shqyrtimit, BQK-ja do të japë komente duke kërkuar nga aplikuesi informata shtesë ose sqarime në lidhje me çdo pjesë të aplikacionit.

Aplikuesi duhet të njoftojë BQK-në kur planifikohen ndryshime potenciale të rëndësishme apo edhe kur mund të ndodhin. Personeli i BQK-së për licencim duhet të jetë vigjilent për një numër të ndryshimeve të vogla që ndodhin gjatë procesimit të aplikacionit. Korrigjimet e rëndësishme apo ndryshimet në aplikacion përveç atyre të nevojshme, për ta bërë aplikacionin teknikisht të kompletuar, mund ta shtyjë BQK-në të konkludojë se aplikacioni fillestar është vjetruar. Në raste të tilla, aplikacioni fillestar do të konsiderohet si i tërhequr ndërsa do të kërkohej një aplikacion i ri për dorëzim dhe një pagesë e tarifës. Nëse nuk është i nevojshëm aplikacioni i ri, por korrigjimet apo ndryshimet rezultojnë rezultojnë në shqyrtim shtesë të konsiderueshëm si dhe procesim nga ana e BQK-së, atëherë mund të ngarkohet edhe një tarifë shtesë.

Personeli i licencimit shqyrton aplikimin dhe listën kontrolluese të bashkëngjitur për saktësi dhe kompletim. Korrigjimet e vogla do të trajtohen përmes korespondencës me email. Nëse kërkohej korrigjime të shumta teknike, atëherë do të dërgohet një letër tek aplikuesit ku do të detajohen korrigjimet e nevojshme. Nevoja për këto korrigjime mund të dërgojë deri te kthimi i aplikacionit.

Aplikuesit në përgjithësi kanë një mundësi që të bëjnë korrigjime teknike. Nëse korrigjimet nuk janë bërë nga grupi dhe brenda afatit prej 15 ditësh atëherë aplikimi mund të konsiderohet si i tërhequr. Pagesa e tarifës nuk do të kthehet. Ridorëzimi i mëvonshëm do të kërkojë përsëri një aplikacion të ri dhe një tarifë shtesë. Departamenti i licencimit mund do të mbajë takim me aplikuesit për të marrë ndonjë informacion shtesë ose ndonjë ndryshim në lidhje me kërkesën. Ky takim do të regjistrohet në procesverbalin e dosjes së aplikuesit.

Pasi aplikacioni është kompletuar teknikisht, personeli i licencimit do të procesojë me një shqyrtim dhe analizë më të thellë të aplikacionit.

Koha e përgjithshme për licencim do të varet nga:

- koha e marrë nga aplikuesi për t'iu përgjigjur komenteve në çështjet e ngritura;
- kualiteti i përgjigjeve të pranuar, duke iu adresuar të gjitha çështjeve të ngritura;
- çdo ndryshim i bërë nga aplikuesi gjatë procesit të aplikimit; dhe
- koha e shpenzuar nga çdo palë e tretë përkatëse për t'iu përgjigjur çështjeve në lidhje me aplikimin.

BQK-ja do të kërkojë referencat dhe mendimet e nevojshme nga autoritetet mbikëqyrëse vendore. Kërkesat mund tu bëhen gjithashtu edhe autoriteteve mbikëqyrëse të jashtme në juridiksionin e të grupit/ kompanisë amë të aplikuesit që ka një prani të konsiderueshme.

Vlerësimi do të bazohet kryesisht në informatat e përmbajtura në aplikacion dhe në informatat tjera që janë në dispozicion të BQK-së, si rezultatet e aktiviteteve të saj mbikëqyrëse. Personeli për licencim do

t'i shqyrtojë kualifikimet dhe kushtet financiare të aplikuesit, kryeshefit ekzekutiv të propozuar dhe menaxhmentit të lartë. Kriteret e mëposhtme duhet të merren në konsideratë:

- Drejtorët e propozuar duhet të përmbushin të gjitha kërkesat ligjore.
- Drejtorët e propozuar duhet të kenë kualifikim të duhur profesional dhe përvojë bankare, financiare apo biznesore.
- Drejtorët e propozuar kanë njohuri në lidhje me tregun dhe shërbimet që duhet të ofrohen.
- Drejtorët e propozuar dhe kryeshefi ekzekutiv janë të njohur me procesin e aplikimit dhe do të marrin pjesë në mënyrë aktive në organizimin dhe operimin e bankës.
- Kryeshefi i propozuar duhet të ketë përvojën e përshtatshme për ndjekjen e planit të ri të biznesit të bankës, dhe të jetë i njoftuar gjerësisht për planin e biznesit.
- Aksionarët kryesorë kanë forcë financiare për të mbështetur investimet e tyre.
- Aksionarët ,drejtorët e propozuar, kryeshefi ekzekutiv dhe menaxherët e tjerë janë persona me integritet të lartë.
- Menaxhmenti i bankës duhet të operojë si një konkurrent i qëndrueshëm dhe i sigurt në tregun në të cilin planifikon të shërbejë.
- Aftësitë dhe kualifikimet e menaxhmentit të propozuar.
- Shkalla në të cilën aftësitë e tilla të menaxhimit dhe kualifikimet do t'i përmbushin nevojat e bankës së re.

Personeli i licencimit do të kryejë verifikimin e historikut të gjithë aplikuesve, kryeshefit ekzekutiv të propozuar, ndonjë menaxheri tjetër të lartë, drejtorëve dhe aksionarëve kryesorë të identifikuar në aplikacion. Verifikimi i historikut jep informata mbi kompetencën, përvojën, integritetin dhe aftësinë financiare të çdo personi të përmendur në aplikacion dhe japin një përcaktim të pavarur për saktësinë dhe tërësinë e informacionit të paraqitur. Informacionet e marra nga BQK-ja për hetimin për historikun mund të ndahen me agjencione, institucionet e tjera financiare rregullatore. Hetimet standarde për historikun janë adaptuar nga BQK-ja dhe duhet të kryhen për të gjithë aplikuesit, kryeshefin ekzekutiv të propozuar, menaxherët e lartë, drejtorët dhe aksionarë kryesor (shih seksionin 5- Hetimet për historikun parimet i përshtatshëm dhe i duhur në këtë manual).

Departamenti i Licencimit dhe Standardizimit mund të kërkojë informata shtesë për të bërë një përcaktim të pavarur për saktësinë dhe kompletimin e çdo informate që përmban aplikacioni për licencim.

Personeli i licencimit do të kërkojë opinione gjyqësore për të verifikuar nëse çështjet ligjore përkatëse (nëse ka ndonjë) janë të zgjidhura ose janë ende në proces.

Kur procesi i shqyrtimit kryhet me sukses, personeli i licencimit do të përgatitë një raport rekomandues me një opinion në lidhje me aplikacionin. Ky raport do t'i paraqitet së pari ZVMF , mandej edhe Bordit Ekzekutiv të BQK-së për vendimmarrje.

SHËNIM: Një licencë do të jepet vetëm atëherë kur BQK-ja është e kënaqur me plotësimin e të gjitha kushteve dhe kërkesave nga aplikuesi.

Bordi Ekzekutiv i BQK-së do të marrë një vendim duke u bazuar në autorizimin që i jep legjislacioni në fuqi. Nëse BQK-ja nuk ka kundërshtime ndaj aplikacionit për të themeluar një bankë, ajo nxjerr vendim

per miratimin paraprak te kërkesës per licencë.

Aplikacionet për të themeluar një bankë do të aprovohen në përgjithësi nëse:

- Kryeshefi ekzekutiv, menaxhmenti i lartë dhe bordi i drejtorëve kanë përvojë të kënaqshme profesionale dhe biznesore.
- Analiza e tregut është e dokumentuar mirë dhe e arsyeshme për tregun.
- Planifikimet dhe objektivat janë realiste dhe të sakta.
- Kapitali i propozuar është i përshtatshëm për tregun dhe produktet dhe planet për të mbajtur kapitalin janë realiste dhe nuk rrjedhin nga borxhi.
- Planet për të punësuar personel shtesë në bankë janë në përputhje me objektivat e planit të biznesit.
- Forca e ekonomisë së vendit përputhet me planin e biznesit.

SHËNIM: Aplikuesi mund të fillojë organizmin e bankës sapo të marrë njoftimin për miratimin paraprak nga ana e BQK-së. Megjithatë, puna e bankës nuk mund të fillojë deri sa të jepet një licencë përfundimtare.

4.4. Letra e mbështetjes

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do të presë që banka amë e aplikuesit për licencë që të dorëzojë një letër mbështetëse, drejtuar BQK-së të formuluar si në formën e mëposhtme: (Nëse licenca është siguruar, BQK ja mund të kërkojë nga banka amë që të freskojë letrën kohë pas kohe.)

“Ne ju shkruajmë për të konfirmuar se [emri i institucionit të propozuar bankar] është një subjekt i varur në pronësi të plotë të [emri i bankës amë]. Struktura e bashkangjitur e strukturës së grupit tregon zinxhirin e pronësisë në mes [emri i bankës amë] dhe [emri i institucionit të propozuar bankar].

Është në interesin komercial të [emri i bankës amë] se [emri i institucionit të propozuar bankar] vazhdon të përmbushë gjatë gjithë kohës detyrimet dhe obligimet e saja që ka ndaj klientëve.

Prandaj ne e njohim përgjegjësinë mbi të dhe obligimet juridiket cilat mund të ekzistojnë për të mbrojtur stabilitetin financiar të saj dhe të sigurohemi se ajo është gjithmonë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj dhe konfirmojmë se ne do të përmbushim këtë përgjegjësi.

5. HETIMET PËR HISTORIKUN

Parimet i përshtatshëm dhe i duhur

5.1. Zbatueshmëria

Përshtatshmëria e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të propozuar konsiderohet si thelbësore në procesin e BQK-së për licencimin dhe mbikëqyrjen e bankave. Si pjesë e procesit të licencimit, BQK-ja ka përcaktuar standarde dhe kritere “i duhur dhe i përshtatshëm” dhe kriterin e pavarësisë për pranimin adekuat të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë. Këto kritere gjenden në Rregulloren e BQK-së për drejtorët dhe menaxherët e lartë të bankave. BQK-ja gjithashtu merr në konsideratë kërkesat e nenit 35 të Ligjit mbi bankat në dhënien e vlerësimit para se të japë aprovim për këta individ.

Këto udhëzime përfshijnë politika dhe procedura të përdorura nga BQK-ja për të shqyrtuar historikun e personave dhe kompanive të caktuara të interesuara të hyjnë në sistemin bankar dhe financiar. Këto udhëzime i detajojnë kontrollet e detyrueshme të standardeve për shtetasit kosovarë dhe shtetasit e huaj; hetimet standarde shtesë të detyrueshme për shtetasit e huaj dhe përshkruan hetime të tjera opcionale të historikut për aplikues të caktuar dhe shënime tjera.

5.2. Politikat kyçe

Sipas kërkesave të ligjit mbi bankat, BQK-ja kryen një hetim lidhur me historikun e personave të propozuar si zyrtar të lartë ekzekutiv, drejtor dhe aksionar kryesor të bankave dhe institucioneve të tjera financiare si dhe menaxher të degëve të bankave të huaja apo zyrave përfaqësuese. Këto hetime kryhen për të përcaktuar nëse ata që janë propozuar, e kanë përvojën, kompetencat, integritetin, karakterin, aftësitë financiare dhe vullnetin për të drejtuar/ apo udhëhequr një institucion financiar në një mënyrë të sigurt, të shëndoshë dhe ligjore. BQK-ja mund të ndajë me rregullatorët e institucioneve të tjera financiare çfarëdo informacioni që e pranon si rezultat i hetimeve të saja.

Testet e përshtatshmërisë zakonisht kanë për qëllim të vlerësojnë kompetencën e menaxherëve dhe drejtorëve si dhe kapacitetin e tyre për të përmbushur përgjegjësitë e pozitave të tyre, përderisa testet e “i duhur” kërkojnë që të vlerësojnë integritetin dhe qëndrueshmërinë e tyre. Kompetencat, kualifikimet formale, përvoja e mëhershme si dhe historikut janë disa nga elementet mbi të cilat fokusohen mbikëqyrësit. Për të vlerësuar integritetin dhe përshtatshmërinë, elementet të cilat merren në konsideratë përfshijnë: të dhënat mbi veprat penale, pozitën financiare, veprimet civile kundër individëve për ndjekjen e borxhit personal, refuzimi i anëtarësimit apo përjashtimi nga organizatat profesionale, sanksione të zbatuara nga rregullatorët e industrive të ngjashme dhe praktikrat e mëhershme të dyshimta të biznesit.

Objektivat

1. Të sigurojë që mbikëqyrësit e subjekteve brenda një konglomerati financiar janë të aftë të ushtrojnë përgjegjësit e tyre për të vlerësuar nëse këto subjekte janë duke u menaxhuar dhe udhëhequr në mënyrë të qëndrueshme dhe të matur dhe nëse aksionarët kryesor (siç janë definuar më poshtë) nuk janë burim i dobësisë për këto subjekte.
2. Të takohen me mbikëqyrësit e duhur në mënyrë që të shkëmbejnë informatat mbi individët dhe subjektet e rregulluara, bazuar nga rasti në rast, kur kërkohet nga mbikëqyrësit tjerë të arrijnë objektivat të vendosura më lartë.

5.3. Përmbledhja e procesit

Kurdo që një person kërkon të hyjë si një anëtar i bordit të drejtorëve, zyrtar i lartë ekzekutiv, anëtarë i menaxhmentit të lartë apo aksionar kryesor (për shembull, propozon të marrë 10 përqind apo më tepër të aksioneve) të një banke të re të propozuar apo institucioni tjetër financiar apo si menaxher i një dege të huaj, Departamenti për Licencim dhe Standardizim kërkon që ai person të dorëzojë ose CV-në individuale, CV-në e aksionarit apo raportin e kompanisë (RK) që gjendet në Shtojcën A-C në këtë manual. BQK-ja gjithashtu kërkon dorëzimin e këtyre raporteve me llojet e mëposhtme të kërkesave: ndryshimet në kontrollin e bankës bazuar të nenin 37 të Ligjit për bankat; dhe ndryshimet e drejtorëve apo zyrtarëve të lartë ekzekutiv bazuar të nenit 34 të Ligjit për bankat.

Të gjitha informatat në çdo kërkesë të korportatës shqyrtohen dhe mund të verifikohen. Çfarëdo keqinterpretimi apo shtrembërimi të fakteve do të rezultojë në mos aprovim. Nëse vërtetohet se ndonjë shtrembërim mund të përbëjë një faktor negativ që tregon se përshtatshmëria dhe korrektësia e individit janë në dyshim. BQK-ja do të bëjë përcaktimin e vet bazuar në të gjitha faktet dhe rrethanat që rrethojnë faktorin negativ. Megjithatë, BQK-ja në përgjithësi do të supozojë ekzistimin e një faktori negativ që do të thotë se personi në fjalë nuk është mjaft i përshtatshëm dhe i duhur që të mbajë pozitën e paraparë, përveç nëse dëshmohet e kundërta.

Faktorët negativ të nenit 35 të Ligjit mbi bankat që do të duhet të merren në konsideratë kur bëhet vlerësimi i përshtatshmërisë dhe korrektësisë janë:

- a) Faktorët negativ penal;
- b) Faktorët negativ financiar;
- c) Faktorët negativ mbikëqyrës;
- d) Faktorët negativ tatimor;
- e) Faktorë të tjerë negativ;

Faktorët e negativ penal

BQK-ja do ta konsiderojë një person si të padenjë për të mbajtur pozitën e paraparë nëse personi është dënuar me vendim gjyqësorë për kryerje të ndonjë nga veprat penale në vijim; apo për tentimin e kryerjes të një veprë të tillë; apo për përgatitjen, nxitjen e ndonjë kundërvajtje të tillë apo duke qenë bashkëpunëtorë në ndonjë kundërvajtje të tillë.

Kundërvajtjet ekonomike

- 1) Krime pronësore apo të tjera-vjedhja e zakonshme, vjedhja e rëndë, përvetësimi, kundërvajtjet monetare, falsifikimi dhe vepra të ngjashme, dhënia e qëllimshme e informatave të rrejshme, mashtrimi, falsifikimi, trajtimi i dëmshëm i kreditorëve, përdorimi i parave të vjedhura apo pronave të tjera me qëllim.
- 2) Shpërlarja dhe pastrimi i parave;
- 3) Kundërvajtjet ekonomike për të cilat mund të shqiptohen dënimet penale, dispozitat në lidhje me raportimin e transaksioneve të pazakonshme apo dhënia e paautorizuar e shërbimeve financiare.
- 4) Shkelje e legjislacionit tatimor për të cilin mund të ngarkohen dënime penale;
- 5) Shkelje serioze të kryera nga një shërbyes civil;
- 6) Krimet lidhur me rrezikimin e rendit publik apo dëmtimin e pronës publike.

Kundërvajtjet e dhunës

1. Kundërvajtjet e dhunës- kundërvajtjet kundër jetës, dëmtimit truporë, kërcënime të dhunës apo krimi, vrasje pa qëllim, paramendim apo dëmtime truporë, krime kundër mirësjelljes shoqërore, grabitjen apo shantazhin.

Veprat që sugjerojnë pandershmëri

- 1) Përdorimi i rremë i emrit, titullit akademik etj, krijimi i përshtypjes së rremë të veprimit në baza të autoritetit zyrtar, në mbështetje apo dijeninë e autoritetit zyrtar, duke kryer aktivitetet ekonomike në mënyrë të paautorizuar;
- 2) Dhënia e informatave të rrejshme apo shkelja e detyrimit për të dhënë informata;

Kundërvajtjet lidhur me drogën

- 1) Kontrabanda e qëllimshme, prodhimi, shitja, dorëzimi etj apo posedimi i drogave të rënda;
- 2) Vepra përgatitore sa i përket përgatitjes, shitjes, transportimit, etj dhe kontrabanda e drogave të rënda, kontrabanda e qëllimshme, shitja, transportimi etj, posedimi dhe prodhimi i drogave të lehta.

Kundërvajtjet lidhur me armët dhe municionet

- 1) Prodhimi apo posedimi i paligjshëm i armëve apo municionit të caktuar;
- 2) Mundësimi i importimit apo eksportimit të disa armëve të caktuara pa autorizim;
- 3) Transportimi i paligjshëm i armëve apo municionit pa autorizim apo leje;

Kundërvajtjet e trafikut rrugor

- 1) Vrasja apo lëndim i paqëllimshëm, aksidenti dhe ikja nga vendi i aksidentit, vozitje nën ndikimin e alkoolit apo drogave;
- 2) Vozitja e automjetit pas suspendimit të lejes;
- 3) Refuzimi për të bashkëpunuar në ndonjë hetim.

Fakte apo Rrethana të tjera

BQK-ja gjithashtu mund të marrë në konsideratë faktet apo rrethanat, që jo domosdoshmërisht rezultojnë në sanksion penal por që mund të tregojnë në mënyrë të arsyeshme se personi në fjalë është i përfshirë në një apo më shumë nga kundërvajtje penale të përmendura më lart. Një përcaktim i tillë mund të jetë i bazuar në raportet zyrtare të bëra nga zyrtarët kompetent për të hetuar kundërvajtjet penale në Kosovë apo diku tjetër apo dokumente të ngjashme.

Faktorët negativ financiar

Faktorët negativ financiar përfshijnë, por nuk janë të kufizuar vetëm me:

- a) Personin përkatës apo çfarëdo personi juridik me të cilin ky person është apo ka qenë i përfshirë, ka pasur probleme të mëdha financiare të cilat kanë rezultuar me procedura ligjore, rikthimin apo mbledhjes së detyrueshme në Kosovë apo diku tjetër.
- b) Urdhëri për falimentim, apo vendime të ngjashme ligjore në Kosovë apo diku tjetër, është bërë apo zbatuar sa i përket personit në fjalë apo cilitdo personi juridik me të cilin ky person është apo ka qenë i përfshirë.
- c) Personi në fjalë është aktualisht i përfshirë në një apo më shumë procedura ligjore në Kosovë apo diku tjetër për shkak të problemeve financiare, apo pritet të përfshihet në procedura të tilla.
- d) Sipas mendimit të BQK-së, detyrimet financiare të personit në fjalë nuk kanë ndërlidhje të arsyeshme me të ardhurat dhe/apo pasurinë e atij personi;
- e) Personit në fjalë i është kërkuar të paguajë borxhet e kaluara për shkak të përgjegjësisë për falimentimin e çfarëdo personi juridik me të cilin ky person është apo ka qenë i përfshirë, në pajtim me legjislacionin e falimentimit apo dispozita ligjore të përkatëse ligjore diku tjetër.
- f) Fakte apo rrethana tjera, që sipas mendimit të BQK-së, janë të ngjashme me ato të renditura në nënparagrafët (a) deri te (e).

Faktorët negativ mbikëqyrës

Faktorët negativ mbikëqyrës përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm nga:

- a) Personi në fjalë ka dhënë informata të pasakta dhe/apo të pakompletuara cilitdo autoritet mbikëqyrës financiar (në Kosovë apo diku tjetër)
- b) Personi në fjalë, apo ndonjë person juridik me të cilin personi në fjalë është apo ka qenë i involvuar:
 - i. ka qenë i refuzuar, apo i është revokuar ndonjë licencë, autorizim, leje apo dokument i ngjashëm, apo është shkarkuar nga ndonjë autoritet mbikëqyrës financiar në Kosovë apo diku tjetër;
 - ii. ka qenë i përfshirë në ndonjë çështje, në Kosovë apo diku tjetër, që ka rezultuar në ndërmarrjen e masave korrigjuese, sanksioneve, ndëshkimeve, apo ndërmarrjen e veprimeve të ngjashme sa i përket personit në fjalë apo personit juridik nga cilitdo autoritet mbikëqyrës financiar;
 - iii. i është refuzuar regjistrimi, inkorporimi apo ndryshimi i dokumentit të themelimit në pajtim me Ligjin për shoqërinë tregtare Nr.. 02/L-123, apo me legjislacionin përkatës të ndonjë vendi të huaj.
- c) Fakte apo rrethana tjera që, në mendimin e BQK-së janë të ngjashme me ato të listuara në nënparagrafët (a) apo (b).

Faktorët negativ të tatimit

Faktorët negativë të tatimit përfshijnë, por nuk janë të kufizuar, me shqiptimin e dënimeve civile apo penale për një apo më shumë nga shkeljet ligjore të përcaktuar me në Ligjet e tatimit në Kosovë, siq mund të jenë:

- a) Paraqitja e qëllimshme e pasaktë apo e pakompletuara e deklaratës tatimore nga personi në fjalë apo ndonjë person juridik me të cilin personi në fjalë është apo ka qenë i përfshirë dhe në të cilën personi në fjalë ka pasur përgjegjësi për dorëzimin e deklaratës së tillë.
- b) Me qëllim apo nga neglizhenca e rëndë është deklaruar tatim për një shumë të pamjaftueshme, apo është shmangur ndonjë tatimi, sa i përket personit në fjalë apo ndonjë personi juridik me të cilin ky person është apo ka qenë i përfshirë;
- c) Tatimet që duhet të paguheshin nga personi në fjalë, apo ndonjë person për të cilin personi në fjalë ka qenë përgjegjës për dorëzimin e tatimit mbi pagën, nuk janë paguar në kohë;
- d) Me qëllim apo nga neglizhenca, duke deklaruar tatim të pamjaftueshëm, apo shkaktimi i mospagimit të tatimit në kohë, sa i përket personit në fjalë apo personit juridik me të cilin personi në fjalë është apo ka qenë i përfshirë, dhe për të cilin personi në fjalë ka pasur përgjegjësi për kryerjen e pagesave të tilla.
- e) Ndonjë fakt apo rrethanë tjetër, që në mendimin e BQK-së janë të ngjashme me ato të listuara në nënparagrafët (a) deri në (d).

Faktor të tjerë negativ

Faktorët e tjerë negativë përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm nga:

- a) Personi në fjalë është apo ka qenë, subjekt në procedurat hetuese dhe disiplinore nga ndonjë organizatë përgjegjëse për rregullimin e ndonjë profesioni, brenda apo jashtë Kosovës, duke përfshirë profesionin ligjorë, kontabilitetit, auditimit, sigurimit dhe kjo procedurë ka dërguar në ndërmarrjen e masave nga organizata të tilla në lidhje me personin në fjalë;
- b) Personi në fjalë është apo ka qenë i nënshtruar ndaj masave disiplinore (përfshirë vërejtjen, qortimin, suspendimin apo largimin nga puna) nga ana e punëdhënësit të tanishëm apo të mëparshëm të tij/saj në lidhje me mos përmbushje të detyrave të tij/saj apo shkleje të kodit të mirësjelljes gjatë kryerjes së punës së tij/saj;
- c) Personi në fjalë apo ndonjë person juridik me të cilin personi në fjalë është apo ka qenë i përfshirë, është hetuar nga ndonjë autoritet publik në Kosovë apo diku tjetër, apo është përfshirë në procedurat ligjore që mund të sugjerojnë pandershmërinë, mashtrimin, apo praktikën e papërshtatshme të biznesit nga ana e personit në fjalë apo një subjekti të tillë;
- d) Personi në fjalë nuk mund të shërbejë si drejtor apo menaxher i lartë nëse ai person në gjashtë muajt paraprak ka shërbyer në ndonjë pozitë në kuadër të BQK-së.

Rrethanat e jashtëzakonshme

Pas kalimit të dhjetë vjetëve, duke qenë të kënaqur sa i përket kualifikimit, përvojës profesionale dhe sjelljes së një personi, BQK-ja mund ta lirojë një drejtor apo menaxher të lartë nga faktorët vijues negativ:

- a) Personi është larguar nga një pozitë në një bankë nga BQK-ja
- b) Personi është dënuar nga një gjykatë penale për një vepër për të cilën personi është apo ka mundur të dënohet me burgim për një periudhë prej një viti a po më shumë, ku nuk ka ekzistuar mundësia e gjobës;
- c) Personi ka qenë drejtor apo menaxher i lartë i një banke licenca e së cilës është revokuar apo falimentimi apo likuidimi jo vullnetar është filluar gjatë mandatit të atij personi.

Kërkesat specifike

Verifikimet standarde të historikut

BQK-ja ndërmerr verifikime shtesë të historikut për qytetarët vendorët dhe të huajt që kërkojnë të përfshihen në sistemin bankar dhe financiar të vendit. Këto verifikime standarde të historikut kryhen për të siguruar informacione të ngjashme me atë të përpiluar për kosovarët dhe shtetasit e huaj dhe kryhen në bashkëpunim me:

- Departamenti për analizë të krimit -Ministria e Punëve të Brendshme;
- Regjistrin e kredive të Kosovës;
- Rregullatorët e mbikëqyrësve të bankave apo subjekteve tjera;
- Autoritetet tatimore;
- Njësia e Inteligjencës Financiare;
- Informatat nga gjykata lokale dhe zbatuesit tjera të ligjit;
- Burime të tjera.

BQK-ja do të bëjë edhe verifikime tjera shtesë të historikut që beson se është e nevojshme për rrethanat individuale.

BQK-ja në raste individuale, mund të heq dorë nga verifikimet standarde të historikut, nëse një verifikim i tillë do të ishte e tepërt apo që nuk do t'i shërbejë qëllimit të BQK-së për hetimin e historikut. Megjithatë, personeli i caktuar do të dokumentojë të gjitha këto çështje në dosje, duke përfshirë edhe arsyeshmërinë për mos verifikim.

Nëse BQK-ja është e gatshme të aprovojë me kusht një person për të cilin ajo nuk ka marrë përgjigje branda 30 ditësh nga të gjitha hetimet kontrolluese të historikut të saj, dhe nuk ka asnjë arsye të besohet se ndonjë informacion i dëmshëm do të gjendet nga hetimet e papërfunduara. BQK-ja mund të lëshojë aprovim të kushtëzuar duke futur në letrën e miratimit si shembull tekstin në vijim:

“Kontrollet e historikut të personit të kërkuara nga BQK-ja ende nuk janë pranuar nga organet përkatëse kompetene. Kështu që, BQK ka vendosur që të mos vonoj kërkesën e juaj, duke lëshuar aprovimin e kushtëzuar. Aprovimi final i personit në fjalë varet nga përfundimi i kënaqshëm i procesit të verifikimit të historikut të tij/saj”.

6. PËRMBAJTJA E PLANIT TË BIZNESIT

Plani i biznesit

Aplikanti duhet të paraqesë një plan të biznesit trevjeçar i cili duhet të ndjekë formatin e shënuar më poshtë dhe ta mbështesë me një letër autorizim nga kompania.

Bankat, si çdo organizatë, duhet të kenë një plan biznesi/strategjik i cili i përcakton objektivat dhe strategjitë e bordit të drejtorëve. Plani duhet të ofrojë prioritetet themelore dhe udhëzimet për menaxhimin e brendshëm dhe duhet të miratohet nga bordi i drejtorëve. Plani nuk duhet të jetë një dokument statik, por duhet të lejojë ndryshime dhe fleksibilitet ashtu siç mund të kërkohej nga rrethanat. Ndryshimet e detajuara në planin e biznesit duhet të miratohen nga bordi i drejtorëve dhe pastaj të përfshihen në një plan të ndryshuar. BQK-ja do të shqyrtojë planin e biznesit apo atë strategjik të një institucioni gjatë ekzaminimeve periodike, ose kur lindin çështje tjera rregullative.

Grupet organizative që aplikojnë për një licencë bankare duhet të paraqesin për shqyrtim një plan të detajuar të biznesit si pjesë të procesit të aplikimit. Nga një institucion gjithashtu mund të kërkohej që të paraqesë një plan biznesi të ndryshuar, atëherë kur krijon një degë ose bën ndryshime të rëndësishme në operacione.

Më poshtë është një format i sugjeruar për përgatitjen e një plani të biznesit:

Plani i biznesit duhet të paraqesë të dhënat e sakta që pasqyrojnë gjendjen ekonomike të tregut të përcaktuar dhe trajton ndryshimet statusore dhe rregullative të cilat mund të ndikojnë në veprimtarinë e bankës së propozuar. Propozimet duhet të pasqyrojnë "realitetin" e tregut.

Plani duhet të përmbajë informacione të vazhdueshme për të treguar se banka e propozuar ka supozime të arsyeshme dhe realiste. Në këtë drejtim, një listë e detajuar e të gjitha supozimeve të përdorura në përgatitjen e planit operativ duhet të jetë e bashkëngjitur gjatë dorëzimit. (p.sh një analizë e margjinave dhe kostos së fondeve). Pasi që të dorëzohet një aplikacion i plotë teknikisht, BQK-ja nuk do të kërkojë informacione shtesë përveç nëse dalin në pah shqetësime që në mënyrë të arsyeshme nuk është pritur që aplikuesi t'u adresohet.

Prandaj, aplikuesit duhet të sigurohen që parashikimet financiare janë të mbështetura mirë dhe që qëllimet dhe objektivat janë specifike dhe të përcaktuara si duhet në paraqitjen fillestare.

SHËNIM: Personeli i licencimit do të shqyrtojë planin e biznesit për të përcaktuar nëse ai është i kënaqshëm. Nëse janë gjetur mangësi të vogla teknike, plani i biznesit duhet të ndryshohet në mënyrë që të bëhet i pranueshëm.

6.1. Analizat e tregut

Analizohen tregjet ku do të shërbehet. Të përshkruhet tregu në të cilin pritet të ofrohen shërbime në kuadër të karakteristikave ekonomike, p.sh. madhësia, të ardhurat dhe struktura e industrisë dhe e banimit. Të përfshihen ndryshimet e parashikuara në treg, faktorët që ndikojnë në këto ndryshime si dhe

efektet që do të kenë ato në bankën e propozuar. Deri në masën nevojshme për marrjen e vendimeve afariste, përshkruhen dallimet në tregun e produkteve që do të ofrohen, p.sh. ndryshimet në tregun depozitar dhe kreditor. Analiza do të bazohet në përdorimin e të dhënave aktuale ekonomike në dispozicion. Burimet e informacionit të përdorur rishqyrtohen për besueshmërinë e tyre dhe janë të rëndësishme në rishikimin e të dhënave.

Analizimi i konkurrencës. Bëni një liste të konkurrentëve brenda zonës së shërbimeve të tregut, të atyre jashtë tregut që mund të ndikojnë tregjet e shërbyera dhe të çdo konkurenti potencial. Jepeni perceptimin tuaj dhe analizat e strategjive të tyre të tregut si dhe rezultatet e pritura në drejtim të fuqisë relative, aksioneve të tregut dhe çmimeve.

Shpjegoni strategjitë që do t'i ndiqni për të kapur një pjesë të secilit produkt në treg dhe rezultatet që ju prisni t'i arrini.

6.2. Planet dhe objektivat

Të rishikohen supozimet kryesore të planifikimit që përdoren në analizat e tregut dhe në vendosjen e planit dhe objektivave për një bankë të re. Duhet të përfshihen së paku si më poshtë: shtimi i depozitave, shtimi i kredive, zgjerimi i tregut, normat e mundshme të interesit, kostoja e fondeve, kostot tjera, konkurrenca etj. Në varësi prej rrethanave, supozimet planifikuese mund të ndryshojnë për tregjet e ndryshme që duhet të shërbehen.

6.3. Struktura e aseteve dhe detyrimeve

Parashikimet duhet të tregojnë trendët e ardhshme të aseteve dhe detyrimeve, vëllimin për çdo lloj shërbimi, investimet fikse të mjeteve si dhe shpërblimin e menaxhmentit dhe stafit. Parashikimet duhet të bëhen në bazë të supozimeve të planifikuara, të cilat duhet të dorëzohen si pjesë e aplikacionit, analizave të tregut dhe strategjive të diskutuara më lart. Formatet e kërkuara të këtyre parashikimeve janë të paraqitura në Shtojcën D – Forma e projeksioneve financiare në këtë manual. Duhet të përfshihen detajet e mjeteve fikse dhe kostove/shpenzimeve përkatëse.

Diskutoni avantazhet dhe mangësitë e strukturës së propozuar të aseteve dhe detyrimeve, duke përfshirë analizën neto të interesit të diferencës dhe çdo veprim që do të ndërmerret për të zvogëluar rreziqet e mëdha për mes teknikave të duhura dhe sistemeve për menaxhimin e fondit.

6.4. Kapitalizimi / Plani Neto i vlerës

Diskutoni formulën apo bazën e përdorur për të arritur strukturën e kapitalit të propozuar dhe një shpjegim se përse aplikuesit besojnë se shuma e propozuar është e mjaftueshme në vazhdimësinë e faktorëve, strategjive dhe shpenzimeve të tregut të caktuar. Pritet që aplikuesit të mbledhin një shumë të

mjaftueshme për të konkurrar në mënyrë efektive në fushën e tregut dhe në mënyrë adekuate të mbështesin operacionet e planifikuara përveç të gjitha shpenzimeve organizative. BQK-ja mund të kërkojë një shumë më të lartë për të mbajtur mjaftueshmërinë e kapitalit për të mbështetur operacionet e parashikuara deri në fund të vitit të tretë të bankës ose ashtu siç kërkohet ndryshe me kornizë ligjore.

Fillimisht diskutoni planet për ngritjen e kapitalit dhe për të financuar rritjen brenda pesë viteve të para. Shpjegoni se si planet tuaja do të mbajnë bankën në përputhje me rregulloret e BQK-së për mjaftueshmërinë e kapitalit, veçanërisht udhëzimet për trajtimin e pajtueshmërisë me kapital të bazuar në rrezik dhe përfitime.

Aplikacioni duhet të përfshijë planifikimin e kapitalit të bazuar në rrezik duke detajuar ndaras elementet e klasës I dhe klasës II të kapitalit në bazë të formës së projeksioneve. Përfshini një përlllogaritje të proporcioneve të kapitalit të bazuar në rrezik dhe proporcionet e fitimeve. Një formë e llogaritjes duhet të bëhet për tre vitet e para të operimit. "Raporti mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të bankave" përfshihet në shtojcën D - Forma e projeksioneve financiare duhet të plotësohet dhe dorëzohet bashkë me aplikacionin.

Diskutoni numrin e aksioneve të autorizuar, numrin e aksioneve që do të lëshohet, vlera nominale për aksion dhe çmimi i shitjes për aksion.

“BQK-ja në përgjithësi është kundër kapitalit të marrë borxh në një bankë të re”.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës mund të kërkojë informacione shtesë në varësi të përshtatshmërisë së materialeve origjinale të dorëzuara .

6.5. Projeksionet Financiare

Aplikuesit e një banke duhet të përgatitin projeksionet e bilancit të gjendjes, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, mjaftueshmërinë e kapitalit dhe mjeteve të rrezikuara duke përdorur formatin në Shtojcën D - Formën e projeksioneve financiare. Aplikuesit duhet të dorëzojnë deklaratat që paraqesin projeksionet e aseteve, detyrimeve dhe kapitalit për numrin e viteve të parashikuara për të arritur profitabilitetin; megjithatë në minimum prej tre vitesh duhet të paraqiten.

7. EKZAMINIMI I PARA-HAPJES – THEMELIMI I BANKËS SË RE

7.1. Qëllimi

Departamenti për licencim dhe standardizim në konsultim me Departamentin për mbikëqyrje të bankave përcakton se kur kërkohet një ekzaminim i para hapjes (EPH). EPH-ja është hapi i fundit i procesit të licencës finale së bankës. Departamenti i licencimit do të përgatitë një plan të para-hapjes dhe emëron një zyrtar të licencimit që do të jetë përgjegjës për secilin ekzaminim të para-hapjes. Zyrtari i licencimit vlerëson nëse banka është e përgatitur apo jo në mënyrë të duhur që të fillojë operimin. Kërkesa e aplikuesit për këtë ekzaminim të para-hapjes duhet të bëhet së paku 14 ditë para datës së planifikuar për ekzaminim.

Udhëzimet dhe instruksionet e përfshira këtu konsiderohen të kompletuara për procesin e para hapjes. Megjithatë, zyrtari i licencimit mund të hetojë dhe komentojë mbi çdo fushë që ai ose ajo mund ta konsiderojë të jetë relevante.

Zyrtari duhet patjetër të dërgojë komentet e tij apo saj te BQK-ja me rekomandime të veçanta për korrigjimet apo mangësitë e para hapjes, apo me rekomandimin që banka të lejohet që të hapet. Nëse mangësitë janë serioze, BQK-ja mund ta vonojë datën e propozuar për hapje deri sa të jenë kryer korrigjimet e duhura, por jo më shumë se 12 muaj. Gjatë ekzaminimit, zyrtari përgjegjës i licencimit së bashku me personelin e mbikëqyrjes bankare të caktuar për ekzaminimin e para hapjes do t'i diskutojë mangësitë, rekomandimet dhe sugjerimet me të dyja palët; menaxhmentin e propozuar dhe Bordin e drejtorëve. Përfundimisht, zyrtari nuk do ta informojë askënd jashtë BQK-së lidhur me përmbajtjen e ekzaminimit të tij/saj. Bordi ekzekutiv i BQK-së merr vendimin final nëse një bankë do të autorizohet apo jo që të hapet në datën e propozuar. Nëse mangësitë janë të rënda, BQK-ja mund ta tërheqë miratimin preliminar dhe nuk do të lejojë që banka të hapet.

7.2. Qasja

Gjatë kërkesës për EPH-es, një bankë duhet të garantojë gatishmërinë e saj për të filluar biznesin. Megjithatë, para datës së përcaktuar për EPH-ë, zyrtari i licencimit mund të kontaktojë apo vizitojë bankën në mënyrë që të përcaktojë nëse është gati për shqyrtim. Kjo intervistë mund të përfshijë diskutimet në lidhje më politikat dhe procedurat kyçe si dhe për kompletimin e personelit dhe pajisjeve.

Dosja e licencimit dhe organizimit do të shoqërojë kërkesën për EPH-ë. Dosja e licencimit përfshin dokumentacionin, korrespondencat deri te data e aprovimit preliminar dhe një raport përmbledhës të vlerësimit të aplikacionit perkatës për veprimin e sugjeruar. Këto dokumente veçanërisht raporti përmbledhës mund të përdoret nga zyrtari i licencimit për të rishikuar tekstin origjinal të planit të aktivitetit dhe vlerëson nëse janë paraqitur apo jo ndryshime të rëndësishme. Dosja mbi organizimin do të shërbejë si shënim referent i të gjitha komunikimeve mes BQK-së dhe aplikuesve duke ndjekur datën e propozuar të aprovimit preliminar. Me përjashtim të përmbajtjes së planit operativ të aplikacionit, dokumentacioni në këto dosje konsiderohet konfidencial dhe duhet t'i kushtohet kujdes i duhur.

7.3. Procedurat e ekzaminimit para-hapjes

Aplikuesit plotësojnë listën kontrolluese për plotësimin dhe dorëzimin e aplikacionit për licencë bankare që duhet të përfshihet në dosjen e organizimit. Lista kontrolluese duhet të përdoret si udhëzues gjatë EPH-së për shqyrtimin e përshtatshmërisë për qeverisjen e përgjithshme të bankës nga aplikuesit. Çfarëdo devijimi i rëndësishëm në listën kontrolluese që vërehet gjatë EPH-së duhet të diskutohet me Zëvendësguvernatorin për mbikëqyrje financiare (ZGMF). Lista kontrolluese duhet të përdoret si pjesë e letrave të punës për ekzaminimin e para hapjes dhe të ruhet si shënim në dosjet e BQK-së.

Dosja e licencimit përfshin aprovimin preliminar dhe kushtet standarde (të detajuar më poshtë) për organizimin e një banke. Kushtet standarde i caktojnë pikat më të rëndësishme që aplikuesi dhe bankat e reja duhet t'i monitorojnë, shumë nga të cilat janë inkorporuar në EPH-në. Aplikuesit mund të jenë subjekt i kushteve të veçanta bazuar në propozimin e tyre unik. Të gjitha kushtet duhet të plotësohen para hapjes.

Përveç listës kontrolluese, zyrtari i licencimit përgjegjës duhet të shqyrtojë kushtet standarde dhe çfarëdo kushtesh të veçanta në aprovimin preliminar. Shënoni çfarëdo mospërputhje mes këtyre kushteve dhe planit për operimet e propozuar të bankës.

Këto kushte standarde duhet të përfshijnë:

- Pagesat e aksionarëve për minimumin e kapitalit të bankës;
- Punësimin dhe trajnimin e personelit të bankës (shqyrtojë numrin dhe përvojën e personelit të bankës ndërlidhur me vëllimin e pritur të biznesit. Përcaktimin se çfarë programe të trajnimit të punonjësve janë parashikuar);
- Marrja me qira apo blerja e pajisjeve për operim dhe themelimin e sistemit operativ, përfshirë kontrollin dhe auditorin e brendshëm, instalimin adekuat të pajisjeve dhe procedurave të sigurisë;
- Kontratat për qiramarrje, blerje apo zotërim të objekteve të bankës;
- Mbulimi me sigurim nga kompanitë e licencuara nga BQK-ja për objektet dhe pajisjet, së paku për rreziqet kryesore (zjarrin, tërmetin, vërshimet);
- Mbulimi me sigurim nga kompanitë e licencuara nga BQK-ja nga rreziku i trezorit (paratë e gatshme në trezor) dhe paratë në transit;
- Angazhimin e një auditori të jashtëm;
- Një rishikim të politikave të shkruara për menaxhim të rrezikut (monitorim, menaxhim, kontrollim dhe raportim të secilit rrezik);
- Një rishikim të politikave të shkruara për rrezikun e tregut, përfshirë menaxhimin e likuiditetit dhe financimit (duhet të jetë në përputhje me dhe të inkorporojë dispozitat e “letrës këshilluese për Menaxhim të Rrezikut të Likuiditetit” dokument i lëshuar nga BQK-ja;
- Një rishikim të politikave të shkruara për rrezikun e kredisë, përfshirë kontrollin e ekspozimeve të mëdha dhe vlerësimin e kredisë, shqyrtimin e kredisë dhe provizionet e kredive (të sigurohet

- se reflektojnë kërkesat e BQK-së në lidhje me provizionet për humbjet nga kreditë siç janë detajuar në rregulloren për menaxhim të rrezikut kreditor dhe rregulloreve tjera perkatëse);
- Një rishikim të procedurave të shkruara për operim dhe kontroll të brendshëm;
 - Vënë në dukje ndonjë fushë të operacioneve të bankës, ku linjat e autoritetit dhe përgjegjësia e raportimit nuk janë përcaktuar qartë;
 - Ndarje efektive të detyrave;
 - Procedurat efektive të themeluara për kontrollin e parave të gatshme;
 - Procedurat efektive të themeluara për kontabilitet dhe raportim;
 - Procedurat efektive të themeluara për kontroll dhe mbajtje të sendeve; (holdover);
 - Procedurat adekuate të themeluara për të lehtësuar parandalimin e shpërlarjes së parave;
 - Një rishikim të sistemit të TI-së në lidhje me operacionet e zyrave përpara dhe mbrapa, përfshi ofruesit e shërbimeve të TI-së , ofruesit e TI-së për ruajtje (backup) dhe plani për vazhdimësinë e biznesit në një lokacion alternativ; dhe
 - Çfarëdo kushtesh tjera që BQK-ja i konsideron si të duhura.

7.4. Kompletimi i EPH

Siç u përmend në udhëzimin, raporti i EPH-së duhet të detajojë konkludimet specifike të ekzaminimit të para hapjes dhe duhet të përcjellat te ZGMF-ja për shqyrtim të metutjeshëm. Nëse ekzistojnë mangësi serioze që përbëjnë kushte të pasigurta dhe jo të shëndosha operative, ato duhet të zgjidhen para se banka të lejohet të fillojë operacionet. Në këtë drejtim, BQK-ja do të udhëhiqet kryesisht nga konkluzionet e ekzaminimit të para hapjes për të vendosur nëse një bankë mund të fillojë aktivitetin. Në shumicën e rasteve banka nuk duhet të parashikojë hapjen më shpejt se 14 ditë pas fillimit të EPH-së. Aty ku paraqiten mangësi të konsiderueshme dhe serioze të tilla si; shkelje të rregulloreve të BQK-së, abuzime të brendshme, etj, zyrtari i licencimit përgjegjës mund të rekomandojnë tërheqjen e aprovimit paraprak. Një rekomandim i tillë duhet të bëhet vetëm pas konsultimit me BQK-në.

Pas përmbylljes së EPH-së, dosja e licencimit dhe dosja mbi organizimin duhet të kthehen në BQK për kompletim të metutjeshëm. Pjesë të dosjes së licencimit, duke përfshirë aplikacionin dhe plotësimet, mund të përdoren në matjen e performancës së bankës në lidhje me planet e saj origjinale. Dosja mbi organizimin do të përfshihet në sistemin e përgjithshëm të dosjeve të BQK-së.

8. MIRATIMET, LEJET DHE NJOFTIMET E NDRYSHME

Kërkohet miratim paraprak nga BQK-ja për:

8.1. Emërimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë

Neni 34 i Ligjit për bankat thekson se asnjë person nuk mund të bëhet drejtor apo menaxher i lartë pa marrjen e një miratimi paraprak nga BQK-ja. Rregullorja e BQK-së për drejtorët dhe menaxherët e lartë të bankave, përcakton standardet “i përshtatshëm dhe të duhura” dhe kriteret për pavarësi për miratimin fillestar si dhe përshtatshmërinë e tyre të vazhdueshme nga BQK-ja.

Personeli i licencimit duhet të kërkojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e nevojshme në mënyrë që të përcaktojë nëse drejtori i propozuar ose menaxheri i lartë posedojnë kualitetet si në vijim:

- Integritet – histori personale që demonstroi pavarësi dhe parime të shëndosha;
- Gjikim – aftësia për t’iu qasur çështjeve të politikave dhe t’i komunikoj pikëpamjet në mënyrë të qartë;
- Udhëheqja – përvojë të mjaftueshme udhëheqëse dhe në biznes;
- Shkollim – diplomë universiteti në ekonomi, financa, biznes apo ndonjë fushë tjetër relevante;
- Përvojë - së paku pesë vjet përvojë bankare dhe shërbime financiare;
- Kompetenca - njohuri për obligimet që marrin dhe ju besohen dhe që ata propozojnë t’i kryejnë për të mirën e interesave të depozitorëve;
- Mjedis ligjor – njohuri të kornizës ligjore sipas të cilës operojnë bankat në Republikën e Kosovës.

Personeli i licencimit duhet të shqyrtojë udhëzimet e duhura dhe të përshtatshme për verifikim adekuat që gjenden në nenin 5 të këtij manuali. Këto udhëzime përfshijnë politikat dhe procedurat e përdorura nga BQK-ja për të shqyrtuar historikun e personave dhe kompanive të caktuara të interesuar për të hyrë në sistemin bankar dhe financiar.

Kërkesat shtesë

Secili drejtor dhe menaxher i lartë duhet ta dërgojë një raport individual (CV) të kompletuar që gjendet në Shtojcën A të këtij manuali në mënyrë që të përcaktojë përmbushjen e shpejtë të obligimeve të kaluara financiare dhe gjendje ekzistuese të shëndoshë financiare.

Secili drejtor i pavarur (jo-ekzekutiv) duhet të jetë në gjendje të demonstrojë se ata nuk kanë konflikte aktuale apo të perceptuara të interesit midis bankës dhe ndonjë biznesi tjetër ose rolit personal dhe se ata nuk do të jenë subjekt i kontrollit ose ndikimit të panevojshëm nga të tjerët në marrjen e vendimeve si një drejtor banke.

Për t'u siguruar se asnjë mundësi e konfliktit të interesit, aksionet e drejtorëve të pavarur, së bashku me cilindo individ të ndërlidhur, nuk duhet të kalojnë 1% të çfarëdo klase të aksioneve me të drejtë vote apo kapitalit total të bankës apo të ndonjë kompanie holding të grupit që i takon banka.

Kryeshefi ekzekutiv duhet të shërbejë në bord (por jo si kryesues) pa të drejtë vote për derisa të mbajnë pozitën.

Një person nuk mund të emërohet apo të zgjidhet si drejtor ose menaxher i lartë i bankës, nëse ai person ka shërbyer në çfarëdo kohe gjatë gjashtë (6) muajve të mëparshëm në BQK.

Për më tepër, BQK-ja mund të zgjedhë të intervistojë ndonjë drejtor apo menaxher të lartë të propozuar.

8.2. Ndryshimi në kontroll

Blerja e aksioneve mbi 10%

Neni 37 i Ligjit për bankat thekson se asnjë person, që vepron direkt ose indirekt, vetëm apo në bashkëveprim me ndonjë person tjetër, nuk mund të bëhet aksionar kryesor (me 10% apo më tepër) në një bankë pa marrjen e autorizimit paraprak me shkrim nga BQK-ja. Gjithashtu asnjë aksionar kryesor, që vepron direkt ose indirekt, vetëm apo në bashkëveprim me ndonjë person tjetër, nuk mund ta shtojë interesin e pronësisë në një bankë mbi 10, 20, 33, 50 ose 75 përqind (%) të kapitalit pa marrjen e autorizimit paraprak nga BQK-ja.

Aplikuesi duhet të dorëzojë dokumentacionin si në vijim:

- Raportin e kompanisë aksionare (RK) apo CV-të e aksionareve individual që gjinden te Shtojca B dhe C e këtij manuali;
- Emri, nacionaliteti dhe vendbanimi;
- Përvojën e biznesit dhe profesionale për dhjetë vitet e fundit;
- Ndonjë pronar përfitues përfundimtar të paraqitësit të kërkesës, që si rezultat i transaksionit, do të përfitonte në mënyrë indirekte pesë përqind (5%) ose më shumë të interesave të kapitalit të bankës;
- Listën e sipërmarrjeve në të cilat pronarët e propozuar, duke përfshirë pronarët përfitues (siç përshkruhet më lartë), kanë pjesëmarrje, duke specifikuar nivelin e pjesëmarrjeve të këtyre dhe adresat e regjistruara të këtyre sipërmarrjeve;
- Afatet dhe kushtet e përvetësimit e propozuara;
- Burimin dhe shumën e fondeve që shfrytëzohen në kryerjen e përvetësimit;
- Ndonjë plan ose propozim lidhur me ndryshimin kryesor në biznesin, strukturën e korporatës ose në menaxhmentin e bankës;

- Në ndonjë rast kur përvetësimi do të ndikonte që banka të bëhet një subjekt i varur i një banke të huaj, një deklaratë mbi atë se autoriteti i huaj mbikëqyrës përgjegjës për mbikëqyrje të vazhdueshme të bankës së huaj në vendin amë, nuk ka vërejtje në fillimin e propozuar të aktiviteteve në Kosovë dhe ushtron mbikëqyrje globale bankare të konsoliduar ndaj bankës së huaj; dhe
- Informata të tjera që mund të kërkohen nga BQK-ja.

Personeli i licencimit duhet të shqyrtojë udhëzimet e duhura dhe të përshtatshme për verifikim që gjenden në Seksionin 5 të këtij manuali. Këto udhëzime përfshijnë politikat dhe procedurat që përdoren nga BQK-ja për të shqyrtuar historikun e personave dhe kompanive të interesuara për t'u futur në sistemin bankar dhe financiar.

(Shënim: Neni 37 kufizimet nuk aplikohen për përvetësimin e aksioneve në një bankë të huaj që është e licencuar për të operuar me një ose më shumë degë në Kosovë, për aq kohë sa banka e huaj njofton BQK-në për çdo përvetësim ku shuma e aksioneve të përvetësuara është e barabartë ose tejkalon pesë përqind (5%) të kapitalit të bankës së huaj.)

8.3. Bashkimet, konsolidimet dhe përvetësimet e bankave

Bashkimet

Neni 39 i Ligjit për bankat thekson se asnjë bankë nuk mund të bashkohet ose konsolidohet me ndonjë bankë tjetër ose të përvetësojë, qoftë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi tërë ose shumicën e aseteve, apo të marrë detyrimet e ndonjë banke tjetër, pa miratimin paraprak të BQK-së. Neni 3 i Rregullores së BQK-së për bashkimet dhe përvetësimet e bankave përcakton informatat të cilat kërkohen para se banka të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me ndonjë institucion tjetër financiar apo ndonjë kompani tjetër.

(Shënim: Nëse qëllimi i aplikuesit është që të krijojë një institucion të bashkuar si bankë, atëherë BQK-ja mund të kërkojë nga aplikuesi që ta dorëzojë **Aplikacionin për Licencë Bankare – Bankat Vendore** që gjendet te Shtojca 1 e këtij manuali. Gjithashtu, nëse është qëllimi që të bashkohet me bankat e huaja që rezulton në biznesin bankar të Kosovës si një subjekt i varur, atëherë aplikuesi do të duhet të dorëzojë **Aplikacionin për Licencë Bankare, Subjekti i Varur dhe Degët e Bankave së Huaja dhe Grupet Bankare** që gjendet tek Shtojca 4 e këtij manuali).

Personeli i licencimit duhet të kërkojë dokumentacionin në vijim nga aplikuesi në mënyrë që ta aprovojë një bankë të riorganizuar nëpërmjet bashkimit:

- Vendimin e asamblesë së aksionarëve të bankës dhe institucionit financiar të përfshirë në veprim për aprovimin e riorganizimit të tyre nëpërmjet bashkimit:

- Draft/marrëveshjen dhe raportin e detajuar të procesit të bashkimit të nënshkruara nga përfaqësuesit ligjorë të bankave të përfshira në procesin e bashkimit. Marrëveshja dhe raporti janë të hartuar me shkrim dhe në përshtatje me legjislacionin në fuqi;
- Raporti i ekspertit të pavarur të licencuar në fusha të ndryshme, për të vlerësuar kushtet e draft marrëveshjes së bashkimit;
- Draft statuti i bankës pas përmbushjes të procesit të bashkimit;
- Planet strategjike dhe operative për realizimin e bashkimit, ku përfshihen analizat e nevojshme të përvetësimit dhe parashikimet e pasqyrave financiare për bankën e bashkuar;
- Në rast të ndryshimeve lidhur me drejtorët dhe menaxherët e lartë të bankës së bashkuar, atëherë Personeli i licencimit do të ndjekë procedurat e listuara më lartë nën **A. Emërimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë**; dhe
- Strukturën e re të aksionarëve të bankës.

Personeli i licencimit duhet të rekomandojë miratimin e procesit të bashkimit nëse:

- Bashkimi nuk rrezikon gjendjen financiare të bankës së bashkuar;
- Banka e ka sistem të organizimit, menaxhimit, vendimmarrjes dhe teknologjisë informative e cila mundëson integrimin e plotë të bankës së bashkuar në atë mënyrë që të mos e rrezikojë funksionimin e saj;
- Bashkimi është ekonomikisht i arsyeshëm;
- Çdo efekt kundër-konkurrues është qartë mbizotërues nga përfitimet në komoditetin dhe nevojat e komunitetit për t'u shërbyer; dhe
- Në qoftë se kjo nuk do të rezultojë në një efekt negativ në Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës.

(**Shënim:** Është përgjegjësi e bankës për të marrë miratime nga autoritetet e tjera që mund të jenë të nevojshme para se transaksioni të ketë përfunduar).

8.4. Përvetësimet e interesit të kapitalit nga bankat në institucionet financiare

Neni 40 i Ligjit për bankat thekson se; pa miratim paraprak nga BQK-ja, asnjë bankë nuk duhet të përvetësojë, direkt apo indirekt, një interes të rëndësishëm në një institucion financiar. Rregullorja e BQK-së për bashkimet dhe përvetësimet e bankave që thekson në nenin 4 se varësisht nga natyra dhe madhësia e transaksionit, BQK-ja do të përcaktojë se cilat informata shtesë janë të nevojshme para se aprovimi mund të konsiderohet.

Personeli i licencimit do të vlerësojë performancën financiare (klasifikimi CAMELS) nga ekzaminimet më të fundit të bëra në vend të bankës investuese.

Personeli i licencimit duhet të kërkojë dhe shqyrtojë raportin e fundit të auditorit të jashtëm të institucionit financiar i cili do të përvetësohet.

Përveç kësaj, personeli i licencimit duhet të adresojë si në vijim:

- Ndikimin në kapital të bankës investuese;
- Kapaciteti i menaxhmentit të bankës investuese;
- Në rast të ndryshimit të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të bankës investuese, atëherë personeli i licencimit duhet të ndjekë procedurat të listuara më lartë nën **A. Emërimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë**; dhe
- Kur institucioni investues është gjithashtu i rregulluar sipas Ligjit për bankat, përshtatshmëria e bankës investuese si aksionar i institucionit në të cilin investohet sipas neneve relevante të Ligjit për bankat.

8.5. Përvetësimet e interesit të kapitalit nga bankat në kompanitë jofinanciare

Asnjë bankë nuk mund të mbajë, direkt ose indirekt, një interes të kapitalit në personin juridik që është i përfshirë në aktivitete tjera përveç aktiviteteve financiare, nëse interesat e këtilla tejkalojnë:

- një përqindje të caktuar të pronësisë (më shumë se pesë përqind (5%) të interesit në personin juridik;
- 15% të kapitalit të bankës;
- ose kur bashkohen të gjitha interesat e kapitalit të mbajtur nga banka në shoqëritë jofinanciare, tejkalojnë njëzet e pesë përqind (25%) të kapitalit rregullativ të bankës.

Rregullorja e BQK-së për bashkimet dhe përvetësimet e bankave thekson në nenin 5, që banka do të konsultohet menjëherë me BQK-në në atë se si do ta sjellin bankën prapë në pajtueshmëri të plotë.

(Shënim: Interesi i kapitali i që tejkalon dispozitat e nenit 41 nuk do të aplikohen në interesat e kapitalit që janë përvetësuar nga një bankë në mbyllje ose në prag të kthimit të kredisë së dhënë nga banka, në të cilin rast banka ekspozon interesat e këtilla të kapitalit brenda një viti nga data që ato janë përvetësuar apo brenda një periudhe më të gjatë të cilën mund ta lejojë BQK-ja apo interesat e kapitalit të mbajtura nga një bankë si agjent ose administrues i besuar).

Personeli i licencimit duhet të këshillohet me personelin e Departamentin për Mbikëqyrje Bankare në lidhje me veprimet e kërkuara për mënyrën e sjelljes së bankës në pajtueshmëri të plotë.

8.6. Akti i themelimit dhe statuti

Neni 22 i Ligjit për bankat thekson se të gjitha bankat që operojnë në Kosovë duhet ta kenë aktin e themelimit dhe/ose statutin, një kopje e të cilave është miratuar nga BQK-ja. Asnjë bankë, përveç bankës së huaj të licencuar për të operuar me një ose më shumë degë në Kosovë, nuk mund të ndryshojë aktin e saj të themelimit ose statutin pa miratimin paraprak me shkrim të BQK-së. Banka e huaj me degë ose subjekt të varur të licencuar në Kosovë duhet ta njoftojë BQK-në për çdo ndryshim në aktin e saj të

themelimit apo në dokumentacionin ekuivalent të themelimit ose statutin brenda tridhjetë (30) ditëve nga data efektive e ndonjë ndryshimi.

Në përcaktimin e aprovimit për amendamentimin e aktit të themelimit të bankës ose të statutit, personeli i licencimit duhet ta kërkojë dhe rishikojë dokumentacionin si në vijim:

- Një kopje të vërtetuar të aktit të themelimit apo dokumentacionit ekuivalent;
- Një listë të zyrtarëve të bankës të cilët janë aktualisht të autorizuar për të obliguar bankën bashkë me ekzemplarin e nënshkrimeve të tyre dhe një përshkrim të kufizimeve të kompetencave të tyre (nevojitet aprovimi i shumicës së drejtorëve të bankës për të amendamentuar aktin e themelimit dhe statutin e saj)

8.7. Leja e kërkuara nga BQK-ja

Zyrat përfaqësuese

Neni 10 i Ligjit të bankave thekson se asnjë bankë e huaj nuk mund të themelojë dhe operojë me një zyre përfaqësuese në Kosovë pa leje nga BQK-ja. Rregullorja e BQK-së për hapjen e zyrës përfaqësuese brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës përcakton kushtet dhe afatet për një zyre të tillë.

Aplikuesi duhet ofrojë personelit të licencimit dokumentacionin në vijim:

- Një kopje e vërtetuar nga banka e huaj që do t'i kufizojë aktivitetet e zyrës përfaqësuese në dhënien e informatave dhe aktiviteteve të ndërlidhjes, si dhe studimit të tregjeve dhe mundësive të investimit ku banka nuk lejohet të angazhohet në veprimtari bankare nëpërmjet zyrës përfaqësuese.

8.8. Mbajtja e pasurisë së paluajtshme dhe pasurisë së luajtshme

Një bankë që synon të marrë ose të mbajë një pasuri të paluajtshme dhe pasuris të luajtshme që tejkalon 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të klasit të I-rë të bankës, duhet ta paraqesë dhe të marrë miratimin paraprak të BQK-së.

Kur analizojmë një kërkesë për një investim shtesë në premisat e bankës, Divizioni i Licencimit do të marrë në konsideratë:

- Përputhshmërinë me praktikat e sigurta dhe të shëndosha bankare;
- Nëse ndonjë transaksion përfshinë të brendshmit e bankës, dhe nëse po, a janë kushtet e njëjta si ato mbizotëruese në atë kohë për transaksionet e krahasueshme me palët e pavarura;
- Arsyeshmërinë e shumës së premisave të bankës dhe shpenzimet vjetore që kërkohen për të kryer ato në raport me strukturën totale të kapitalit të bankës si dhe natyrën dhe vëllimin e operacioneve;

- Efekti i investimeve në fitimet e ardhshme;

BQK mund të vendosë kushte të veçanta të përshtatshme për miratimin e një investimi shtesë në premisat e bankës, nëse konstaton se ato janë të nevojshme ose të përshtatshme për të mbrojtur sigurinë dhe qëndrueshmërinë e bankës. Këto kushte përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- Ruajtjen e niveleve adekuate të kapitalit.
- Zhvillimi i planeve specifike për të përmirësuar fitimet.
- Zhvillimi i planeve specifike për të përmirësuar likuiditetin.
- Dorëzimi i një vlerësimi për të mbështetur transaksionin.

Nëse investimi përfshin një të brendshëm të bankës, banka duhet të sigurojë informata shtesë në lidhje me kushtet e transaksionit, për shembull:

- Emri i të brendshmit të bankës dhe marrëdhënien e tij / saj me bankën.
- Një përshkrim të mënyrës sesi banka ka përcaktuar korrektesinë sa i përket kushteve, të cilat mund të përfshijnë sigurimin e një kopje të një vlerësimi të pavarur apo dëshmi tjetër të korrektesisë së transaksionit.
- Një kopje e vendimit të bordit të drejtorëve që aprovon transaksionin që reflekton abstenimin e të brendshmit të bankës nga diskutimi dhe votimi.
- Një kopje e ekzekutimit të marrëveshjes së qirasë ose blerjes.
- Një vendim i kontabilitetit nëse qiraja duhet të kapitalizohet.
- Një justifikim i shpenzimeve.

8.9. Njoftimi i kërkuar për BQK-në

Përvetësimi i aksioneve nga 5% deri në 10%

Neni 37 i Ligjit për bankat deklaron se secila bankë duhet të njoftojë BQK-në për çfarëdo përvetësimi të aksioneve brenda pesë (5) ditëve pas përvetësimit nëse shuma e aksioneve të përvetësuara është e barabartë apo tejkalon pesë përqind (5%) të kapitalit por që nuk tejkalon dhjetë përqind (10%).

Borxhi i varur

Për t'u konsideruar si kapitali i klasit II, borxhi i varur duhet të përmbushë kërkesat e paragrafi d të rregullores mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të bankës. Borxhi i varur për të konsideruar si kapital i Klasit II duhet:

- Të ketë një maturitet fillestar mesatar të ponderuar prej mbi pesë vjet.
- Të jetë në vartësi të kërkesave të depozituesve.
- Të definohet si kapital sipas paragrafit d të rregullores mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të bankës;
- Të jetë i pasiguruar;
- Të mos jetë i klasifikuar si kolateral për kredinë e bërë nga banka dhënëse.

Shuma totale e borxhit të varur që një bankë mund të konsiderojë si kapital të klasit II është e kufizuar. Borxhi i varur plus çdo borxh i varur afatmesëm, të përfshirë në kapitalin e klasit II janë të kufizuar në 50 për qind të kapitalit të Klasit I të bankës.

Nga banka kërkohet që të marrë miratimin paraprak të BQK-së për të dhënë borxhin e varur në qoftë se banka nuk është e kapitalizuar mirë, pavarësisht nëse borxhi i varur është menduar që të numërohet si kapital, ose kur BQK e ka njoftuar paraprakisht bankën se nevojitet miratimi paraprak.

Nëse nga banka nuk kërkohet që të marrë miratimin paraprak të BQK-së para lëshimit të borxhit të varur, banka duhet të njoftojë BQK-në me shkrim brenda 10 ditëve pas lëshimit të borxhit të varur për atë që do të konsiderohet si kapital i klasit II. Njoftimi duhet të përfshijë:

- Një përshkrim të kushteve të lëshimit.
- Datën kur janë pranuar fondet dhe shumën.
- Një kopje e formatit përfundimtar të borxhit të varur dhe marrëveshja.

8.10. Dega e bankës së huaj

Themelimi i subjektit të varur nga banka e huaj

Neni 12 i Ligjit për bankat thekson se BQK-ja mund të kërkojë nga banka e huaj që është licencuar për të operuar më një ose më shumë degë në Kosovë që ta kthejë degën në subjekt të varur të bankës së huaj. BQK-ja mund të bëjë këtë kërkesë, nëse BQK-ja ka baza të arsyeshme se banka e huaj apo dega e saj po veprojnë nën kushte apo praktikat të caktuara të pasigurta dhe jo të shëndosha.

Gjithashtu dega e bankës së huaj vullnetarisht mund të vendosë që të kthehet në subjekt të varur. Në marrjen e vendimit për aprovim dokumentet duhet të sigurojnë informatat si në vijim:

- Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve/ Bordit të bankës;
- Certifikata e regjistrimit të biznesit;
- Kopja e certifikuar për ndryshimin e statutit dhe dokumenteve ekuivalente;
- Aplikacioni për aprovim paraprak për personat që janë përgjegjës për udhëheqjen e biznesit të degës;
- Autorizimi ose deklarata prej Autoritetit Mbikëqyrës të vendit që të kthej degën në subjekt të varur;
- Plani strategjik dhe operacional për të realizuar kthimin e degës, duke përfshirë analizat e nevojshme për përvetësim dhe pritjet e pasqyrave financiare për subjektin e varur;
- Lista e personave të propozuar si anëtarë të Bordit të drejtorëve dhe planifikimi për ndryshime në strukturën organizative, menaxheriale dhe në personelin e bankës (shiko Raportin individual);
- Ndonjë informatë tjetër që BQK-ja mund të kërkojë.